

# Udhëzues për administrimin e platformave digjitale

Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe mundësia e përdorimit të informacionit nëpërmjet një qasjeje shumëpalëshe.



Publikuar në vitin 2024 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, 7, Place de Fontenoy, 75352 Paris 07SP, Francë dhe Këshilli Shqiptar i Medias, Rruga e Kavajes, Sh.1 Ap.4, 1000 Tirana, Shqipëri.

ISBN 978-92-3-000224-4

© UNESCO Këshilli Shqiptar i Medias 2024



Ky publikim është i disponueshëm në Open Access nën licensën Attribution-ShareAlike 3.0 IGO (CC-BY-SA 3.0 IGO) (<http://creativecommons.org/licenses/by-sa/3.0/igo/>). Duke përdorur përmbajtjen e këtij publikimi, përdoruesit kushtet e përdorimit të Repozitorit të Hapur të UNESCO-s (<https://www.unesco.org/en/open-access/cc-sa>).

Versioni original: Guidelines for the Governance of Digital Platforms: Safeguarding freedom of expression and access to information through a multistakeholder approach. Botuar për herë të parë në vitin 2023 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), 7, Place de Fontenoy, 75352 Paris 07 SP, Francë.

Përdorimi i emërtimeve dhe paraqitja e materialeve në këtë publikim nuk perfaqson qendrimin e UNESCO-s në lidhje me statusin ligjor, territorin, qytetin ose zonen e asnje shteti, ose të autoriteteve të tyre, ose në lidhje me kufizimin e kufijve të tyre.

Idete dhe mendimet e shprehura në këtë publikim janë ato të autorëve; nuk janë domosdoshmërisht ato të UNESCO-s dhe nuk angazhojnë Organizatën, as Bashkimi Evropian. Në kuadrin e projektit të financuar nga BE-ja " Ndërtimi i Besimit në Media në Europën Juglindore: Mbështetje për gazetarinë si një e mirë publike".

**Dizajni i Koverit, Tipografia dhe Dizajni Grafik:** Luiza Maximo

**Ilustrimet:** Plastic Horse/Grand Matter

**Bashkëpublikimi në Shqip:**

**Përkthyes:** Xhimi Lazëri

**Redaktimi dhe Korrektimi:** Florenc Zerellari

# PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

## Udhëzues për një internet të besueshëm

Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe e të drejtës për informim në kuadrin e dezinformimit dhe të keqinformimit, gjuhës së urrejtjes dhe teorive konspirative, kërkon një qasje me përfshirje shumëpalëshe.

Kjo është arsyeja përse UNESCO, agjencia lider e Kombeve të Bashkuara për nxitjen dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe informimit, ofron këtë Udhëzues për Administrimin e Platformave Digjitale.

Udhëzuesi parashtron një kuadër detyrimesh, përgjegjësish dhe rolesh në lidhje me shtetet, platformat digjitale, organizatat ndërqeveritare, shoqërinë civile, mediat, akademitë, komunitetet teknike dhe palë të tjera në mënyrë që të ndërtohet një mjedis, ku liria e shprehjes dhe e informimit të qëndrojnë në qendër të proceseve të administrimit të platformave digjitale.

Udhëzuesi është hartuar pas një këshillimi shumëpalësh, ku janë marrë më shumë se 10.000 komente nga 134 vende.

Ky proces këshillimi në nivel global është arritur nëpërmjet një pjesëmarrjeje përfshirëse e diversiteti opinionesh, duke përfshirë edhe ato të grupeve të cenueshme e të marginalizuara.

Kultivimi i një interneti të besueshëm do të thotë ndarje e përgjegjësive mes palëve. Kjo na fton të gjithëve të mbështesim një mjedis, i cili mundëson lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim.

**10,000**  
KOMENTE NGA

**134**  
SHTETE



*"Meqenëse se luftërat nisin në mendjen e burrave dhe të grave, atëherë mbrojtja e paqes duhet të ndërtohet pikërisht në mendjen e burrave dhe të grave".*

# Udhëzues për administrimin e platformave digjitale

Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe përdorimi i informacionit nëpërmjet një qasjeje shumëpalëshe

6 **Parathënie**

8 **Objektivat e Udhëzuesit**

11 **Hyrje**

14 **Struktura e Udhëzuesit**

16 Krijimi i mjedisit

24 Sistemi i administrimit

35 Parimi 1. Platformat tregojnë kujdesin e duhur për të drejtat e njeriut

37 Parimi 2. Platformat përputhen me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë në objektivat e tyre shqyrtimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes

42 Parimi 3. Platformat janë transparente

46 Parimi 4. Platformat ofrojnë informacion dhe mjete të disponueshme për përdoruesit

48 Parimi 5. Platformat janë përgjegjëse ndaj palëve kryesore

50 Dispozita të veçanta lidhur me kontekstin

54 **Përfundime**

56 **Shtojcë**

**Parathënie nga Drejtori i përgjithshëm i UNESCO-s, Adrey Azoulay**

## **Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe mundësia e përdorimit të informacionit: Parimet e një qasjeje shumëpalëshe për Administrimin e Platformave Digjitale.**

Shtator 2023

Në vitin 2023, 60% e popullatës globale, ose 4.75 miliard persona, po përdorin platformat e mediave sociale për t'u informuar, për të shprehur dhe për të afirmuar vetveten.

Sfera digjitale përbën një hapësirë lirie dhe një forum të një forme të re të shprehjes, debatit, ndërthurjes së marrëdhënieve sociale e po ashtu edhe të identitetit e të jetës sonë.

Këto platforma janë kthyer në amplifikatorë të kampionëve të barazisë dhe lirisë, duke i dhënë volum fjalëve të personave të pazëshëm dhe duke ofruar një terren të sigurt për forma të ndryshme të shprehjes.

Megjithatë, po këto rrjete sociale, emrat e të cilëve bartin kaq shumë premtime, mund kthehen njëkohësisht edhe në fluska izolimi e dezinformimi të cilat në ndonjë rast mund të ushqejnë teori konspirative dhe dhunë ekstreme.

Si hapësira virtuale të ndërveprimit social, ato mbështeten nga algoritme të menduara enkas për të monopolizuar vëmendjen tonë dhe të favorizojnë pa dashje keqinformimin dhe gjuhën e urrejtjes, duke u dhënë përparësi klikimeve dhe jo sigurisë, gjasave dhe jo provave.

Por, nëse ne nuk do të jemi më në gjendje të dallojmë trillimin nga realiteti dhe gënjeshtren nga e vërteta, themelet e shoqërive tona do të shemben. Demokracia, dialogu dhe debati - thelbësore për trajtimin e sfidave kryesore të kohëve të sotme - do të bëhen të pamundura.

Duke u përballur me përmasat globale të këtyre çështjeve, ne duhet të ngremë përgjigje të bazuara, të qëndrueshme e konsistente në mbarë botën dhe të shmangim rregullimet fragmentare apo qasjet që lëshojnë pe në lidhje me të drejtat e njeriut.

Faktikisht kjo përbën një sfidë globale, me të cilën UNESCO duhet të përballlet, pasi

qëndron edhe në themel të mandatit të organizatës sonë.

Qysh me krijimin e saj, organizata jonë ka punuar për zhvillimin “e njohjes dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis popujve” veçanërisht nëpërmjet “rrjedhjes së lirë të ideve përmes fjalëve dhe imazheve” siç theksohet edhe në Statutin tonë.

UNESCO, duke iu përbajtur këtij zotimi, në vitin 2005 botoi “Udhëzuesin mbi rregullimin e transmetimeve”. Kohët e fundit, “Rekomandimet mbi Etikën dhe Inteligjencën Artificiale” nga ana jonë e të vëna në zbatim nga 193 shtete anëtare, kontribuuan në hartimin e një kuadri humanist për evoluimin e kësaj teknologjie.

Duke i qëndruar besnike vlerave dhe historikut të saj, UNESCO ka punuar për hartimin e një Udhëzuesi novator, të cilin po e paraqesim në këtë botim. Udhëzuesi synon të luftojë keqinformimin, gjuhën e urrejtjes, si edhe të nxisë transparencën dhe lirinë e shprehjes në platformat digjitale.

Këto përpjekje janë orientuar nga “Deklarata Windhoek+30” e vitit 2021, parimet e së cilës u pranuan nga të gjitha shtetet anëtare. Deklarata përcakton tri shtylla veprimi: mbështetjen e transparencës së platformave, garantimin e zbatueshmërisë mediatike dhe nxitjen e mendimit kritik nga ana e përdoruesve.

Kjo përpjekje, e cila finalizohet me këtë Udhëzues, është rezultat i këshillimeve në shkallë të gjerë, të pasuruara nga 10.000 komente, duke i shndërruar ato në procesin më gjithëpërfshirës të kryer nga Kombet e Bashkuara. Vetëm në Konferencën për Internet të besueshëm të organizuar nga UNESCO në shkurt 2023 u mbledhën 4000 palë nga 134 vende.

Ky udhëzues propozon masa të drejta, të qarta e të përbashkëta: moderatorë online në tërë gjuhët, përfshi edhe ato indigjene; transparencë më të madhe nga ana e platformave dhe ndaj financimit të tyre, nëpërmjet një vlerësimi më të mirë të riskut; ngritja e rregullatorëve të pavarur; nxitja e mendimit kritik; mbështetja e barazisë gjinore; dhe, mbi të gjitha, ruajtja dhe forcimi i lirisë së shprehjes, i diversitetit kulturor dhe i të tjera të drejtave të njeriut.

Duke hedhur vështrimin përtej realiteteve aktuale të platformave digjitale, ky tekst trajton gjithashtu edhe sfidat e ardhme, veçanërisht ato që burojnë nga intelijenca artificiale

Le të përqendrohemi në qëllimin tonë: lufta ndaj gjuhës së urrejtjes dhe keqinformimit, si edhe mbrojtja e lirisë së shprehjes. Kjo nuk është kontradiktë. Nëpërmjet fuqizimit të mundësisë për përdorimin e informacionit të lirë e të besueshëm, ne forcojmë lirinë e mendimit dhe të shprehjes.

E thënë me fjalët e Hana Arendit “Liria e opinionit mbetet veçse një farsë, kur nuk garantohet informacioni i bazuar në fakte dhe kur faktet nuk vihen në diskutim”.

# Udhëzues për administrimin e platformave digjitale

Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe mundësisë për informim nëpërmjet një qasjeje shumëpalëshe.

Tetor 2023

## Objektivat e Udhëzuesit

1. Këtë dokument Unesco e ka hartuar mbështetur në parime, konventa dhe deklarata me rëndësi, përmes konsultimesh shumëpalëshe dhe një dialogu në nivel global: *Udhëzuesi për Administrimin e Platformave digjitale*: “Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe mundësia për informim nëpërmjet një qasjeje shumëpalëshe (Udhëzuesi).”<sup>1</sup>
2. Qëllimi i Udhëzuesit është mbrojtja e të drejtës për lirinë e shprehjes, duke përfshirë mundësinë për informim dhe të tjera të drejta të njeriut në administrimin e platformave digjitale, kur bëhet fjalë për ato përmbajtje, të cilat mund të pësojnë kufizime të autorizueshme nga ligjet dhe standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Si rrjedhojë, administrimi i platformave ndërkombëtare, i bazuar në të drejtat e njeriut duhet të nxisë diversitetin kulturor, shprehjen kulturore dhe përmbajtje kulturore të ndryshme.<sup>2</sup> Udhëzuesi e vendos theksin te një sistem administrimi, i cili respekton të drejtat e njeriut, synon uljen e rrezikut dhe nxit proceset për shqyrtim dhe kujdes për sa i takon përmbajtjes. Ky Udhëzues nxjerr në pah parimet gjithëpërfshirëse, të cilat duhen ndjekur në të gjitha ato sisteme administrimi që ndikojnë në lirinë e shprehjes dhe në mundësinë për informim të platformave digjitale - pavarësisht marrëveshjeve rregullatore konkrete dhe fokusit të tematikave, për sa kohë këto marrëveshje janë në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga ky Udhërrëfyes.
3. Udhërrëfyesi pohon se zbatimi i ligjeve dhe rregullave në të gjitha sistemet e administrimit duhet të përputhet me standardet ndërkombëtare të të drejtave të

1. Versioni original i këtij dokumenti është në anglisht

2. UNESCO 2005 Konventa mbi ruajtjen dhe nxitjen e diversitetit të shprehjeve kulturore, neni 1 dhe 4 sipas konventës termi “përmbajtje kulturore” i referohet kuptimit simbolik, artistik, përmasave dhe vlerave kulturore, të cilat burojnë nga identiteti kulturor ose e shprehin atë. Me “shprehje kulturore” kuptohen ato shprehje, të cilat janë rezultat i krijimtarisë së individëve, grupeve e shoqërive dhe kanë përmbajtje kulturore.



njeriut, duke përfshirë edhe Nenin 19 (3) të *Konventës Ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike (ICCPR)*,<sup>3</sup> të cilat parashikojnë se çdo kufizim i lirisë së shprehjes duhet të kryhet me ligj, të ketë një qëllim të përligjur siç është përcaktuar në dispozitë, të jetë i nevojshëm dhe të realizohet në mënyrë të përpjesëtuar; gjithashtu edhe Neni 20 i ICCPR-së dhe i standardeve të tjera ndërkombëtare, veçanërisht interpretimet e dispozitave të këtyre traktateve të ofruara nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, gjykatat ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut, Plani i Veprimit i Rabatit mbi ndalimin e gjuhës së urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, të cilat përbëjnë nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë<sup>4</sup>

4. Udhëzuesi fokusohet në mbrojtjen dhe nxitjen e standardeve të të drejtave të njeriut dhe në mundësimin e një pluraliteti platformash, duke përfshirë ato me karakter të decentralizuar dhe një ekosistem, i cili ka sistemesht shqyrtimi.
5. Udhëzuesi duhet të shërbejë si referim për një sërë palësh: për hartuesit e politikave gjatë identifikimit të objektivave të përligjur, parimeve të të drejtave të njeriut dhe proceseve përfshirëse e pjesëmarrëse, të cilat duhen marrë parasysh në hartimin e politikave; për organizmat qeveritare dhe rregullatore, të cilat merren me zbatimin dhe vlerësimin e politikave, kodet e sjelljes apo ato rregullatore; për platformat digjitale në politikat dhe praktikat e tyre; dhe për palë të tjera, si shoqëria civile në përpjekjet e tyre në përpjekjet e tyre për avokati dhe marrje përgjegjësie. Nga ky Udhëzues mund të përfitojnë gjithashtu edhe mediat e reja informative në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për vënien para përgjegjësisë të aktorëve të rëndësishëm.
6. Udhëzuesi është hartuar në mënyrë të tillë që të shërbejë, si për procedurat specifike të administrimit të përmbajtjes së platformave digjitale, ashtu edhe për procese administrimi, të cilat tanimë mund të zbatohen edhe në fusha të tjera e që mund të kenë ndikim në ushtrimin e lirisë së shprehjes, në shfrytëzimin e informacionit dhe përmbajtjeve të ndryshme kulturore e që duhen konsideruar në dritën e ndryshimeve të hapësirës digjitale (si zgjedhjet, mbrojtja e të dhënave dhe rregullimet antitrust). Në varësi të çështjeve dhe të konteksteve të juridiksioneve, procese të tilla administrimi mund të shikohen si një kombinim i shtyllave plotësuese vetërregullim, bashkërrregullim dhe rregullim statutor - të strukturuar në mënyrë të përputhshme me standardet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut ( Shiko "Sistemi i administrimit" në kapitullin më poshtë). Procese të tilla administrimi duhet të kryhen në një mënyrë të hapur, transparente, shumëpalëshe, proporcionale dhe të bazuara në fakte. Për këtë qëllim, ky udhërrëfyes duhet të shërbejë si dokument aktiv, të jetë subjekt i rishikimeve dhe përditësimeve periodike, duke përfshirë edhe marrjen në konsideratë të mësimave të nxjerra nga zbatimi i tyre, si edhe të ndryshimeve të teknologjisë dhe pasojave që

3. *Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike (ICCPR)*, 1966 <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>.


4. Udhëzuesi duhet të lexohet në përputhje me tërë instrumentet bazë të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, të cilat gjenden në : <https://www.ohchr.org/en/core-international-human-rights-instruments-and-their-monitoring-bodies>.

rrjedhin prej tyre.

- 7.** Udhëzuesi është konceptuar i tillë që të kontribuojë në mënyrë praktike për zgjerimin e përpjekjeve për realizimin e një modeli administrimi digjital, në themel të të cilit qëndron njeriu. Ai është gjithashtu pjesë e një pakete veprimesh më të gjera, të cilat janë të nevojshme për të arritur në një zhvillim të qëndrueshëm. Konkretisht:
  - a.** Të inkurajojë dhe të kontribuojë zhvillimin e një rrjeti shumëpalësh global dhe një të hapësire të përbashkët për të diskutuar e për të ndarë së bashku praktikat e mira në administrimin e platformave digjitale, mbledhjen e vizioneve të ndryshme të një spektri të gjerë perspektivash.
  - b.** Të shërbejë si mjet për të gjitha palët e përfshira, në mënyrë që të punojnë për mbështetjen e masave rregullatore për respektimin e të drejtave të njeriut dhe për t'i bërë të përgjegjshme qeveritë dhe platformat digjitale.
  - c.** Të ofrojë qasje politikash të bazuara në fakte dhe në të drejtat e njeriut.
  - d.** Të nxisë me sa të mundet në nivel botëror konvergjenat e politikave të administrimit të platformave, në mënyrë që të shmangët fragmentarizimi i internetit.
- 8.** Udhëzuesi synon të kontribuojë për proceset në zhvillim në Kombet e Bashkuara e të informohet prej tyre siç është rasti i zbatimit të propozimeve të dokumentit “Agjenda jonë e përbashkët”. Këtu përfshihet zhvillimi i Kompakt Digjital Global<sup>5</sup> përgatitja e takimit të nivelit të lartë të Kombeve të Bashkuara mbi Të Ardhmen, i cili do të mbahet në shtator 2024 dhe krijimin e një Kodi Sjelljeje i cili nxit integritetin e informacionit në platformat digjitale.<sup>6</sup> Udhëzuesi do të ushqejë gjithashtu edhe diskutimet në lidhje me rishikimin e ardhshëm 20 vjeçar të Samitit Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit (WSIS) dhe të Forumit të Administrimit të Internetit (IGF). Ky tekst ka përfutur më tej dhe synon të kontribuojë për nisma të kryesuara nga organizata qeveritare ndërkombëtare, duke përfshirë edhe nga ato me karakter rajonal.

5. Shiko Përmbledhje Politikat e Agjendës sonë të përbashkët nga Sekretarit i Përgjithshëm i OKB-së , me referime të ndërthurura të proceseve që kanë çuar në hartimin e këtij Udhëzuesi. [https://digitallibrary.un.org/record/4011891/files/%5EEOSG\\_2023\\_5%5E--EOSG\\_2023\\_5-EN.pdf](https://digitallibrary.un.org/record/4011891/files/%5EEOSG_2023_5%5E--EOSG_2023_5-EN.pdf).

6. Shiko Përmbledhje Politikat e Agjendës sonë të Përbashkët nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, me referime të ndërthurura që kanë çuar në hartimin e këtij Udhëzuesi: <https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/our-common-agenda-policy-brief-information-integrity-en.pdf>.



## Hyrje

9. UNESCO u themelua në nëntor 1945, duke pasur për mision “kontributin për paqen dhe sigurinë nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit mes kombeve, nëpërmjet edukimit, shkencës dhe kulturës, për të ngritur më lart në shkallë botërore respektin ndaj drejtësisë, sundimit të ligjit, të drejtave dhe lirive themeltare të njeriut, të cilat vlejné për çdo njeri në botë”.<sup>7</sup>
10. Mandati global i UNESCO-s, i cili përfshin nxitjen e “fluksit të lirë të ideve nëpërmjet fjalëve dhe imazheve”, i ka prirë punës së organizatës për gati 80 vjet, duke u shndërruar në një laborator idesh, në një kanal shkëmbimi vlerash e informacionesh, përcaktues standardesh, katalizator, motor i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në ndërtues kapacitetesh. Kjo histori ka formësuar mandatin e organizatës në kuadrin e sistemit të Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen dhe nxitjen e lirisë së shprehjes, përdorimin e informacionit dhe sigurinë e gazetarëve, si atyre online ashtu edhe off-line.
11. Puna dhe angazhimi i vazhdueshëm i UNESCO-s është të mundësojë që administrimi i platformave digjitale të mbrojtë dhe të nxisë lirinë e shprehjes, përdorimin e informacionit dhe të përmbajtjeve të ndryshme kulturore, si edhe të drejtave të tjera të njeriut, ku përfshihen grupet të cenueshme e të marginalizuara.<sup>8</sup>

7. Statuti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë, Neni 1. <https://www.unesco.org/en/legal-affairs/constitution#article-i---purposes-and-functions>.

8. Me “grupet në rrethana të cënueshme dhe të marginalizuara” kuptohen fëmijët dhe adoleshentët, persona me paaftësi; migrantët, refugjatët dhe azilkërkuesit; personat LGBT; dhe persona të tjerë.

- 12.** Kjo përpjekje, që ka nxjerrë mësim nga dhjetëra vite pune të UNESCO-s për rregullimin e transmetimeve dhe si të çdo vendimi qeverie që lidhet me aspekte të përmbajtjes, - pavarësisht burimit të përmbajtjes - duhet të përfshijnë gjithmonë diversitetin dhe lirinë e fjalës, mundësinë e përdorimit të informacionit si qëllim fundor. Udhëzuesi përbën gjithashtu edhe një kontribut për zbatimin e strategjisë afatmesme të Organizatës për periudhën 2022-2029 (41 C/4).<sup>9</sup>
- 13.** Në vitin 2015, Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s mbështeti Parimet Universale ROAM të internetit, të cilat theksuan rëndësinë e **të drejtave të njeriut, hapjes, mundësive të përdorimit të internetit, si edhe pjesëmarrjes shumëpalëshe** në zhvillimin, rritjen dhe evoluimin e tij.<sup>10</sup> Këto parime njohin si nevojë themelore krijimin e mundësive të zhvillimit të hapësirës në rrjet dhe përdorimin e saj në mënyra, të cilat favorizojnë qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- 14.** Qasja shumëpalëshe për zhvillimin dhe zbatimin e parimeve, normave, rregullave, procedurave të përbashkëta të vendimmarrjes dhe programeve, të cilat kontribuojnë në zhvillimin dhe përdorimin e internetit, kanë mbështetur strategjinë e përgjithshme të përdorur nga sistemi i Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe UNESCO-n, qysh nga Samiti Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit (2003 dhe 2005) dhe është riafirmuar nga Asambleja e Përgjithshme gjatë tetë viteve të procesit të rishikimit më 2015:

**Veç kësaj, ne ritheksojmë vlerat dhe parimet e bashkëpunimit shumëpalësh, si edhe angazhimin që ka karakterizuar Samitin Botëror mbi procesin e Shoqërisë së Informacionit qysh në zanafillë dhe pohojmë se pjesëmarrja efektive, partneriteti dhe bashkëpunimi mes qeverive, sektorit privat, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, komuniteteve të teknikëve e akademikëve, si edhe gjithë pjesëmarrësve të tjerë të rëndësishëm në kuadrin e roleve dhe përgjegjësie të tyre përkatëse, veçanërisht atë të përfaqësimit të balancuar në vendet në zhvillim, kanë qenë dhe vazhdojnë të jetë jetikë për zhvillimin e shoqërisë së informacionit.**<sup>11</sup>

- 15.** Konferenca e Përgjithshme e 41-të e UNESCO-s mbështet parimet e *Deklaratës Windoek+30* të nëntorit 2021 dhe është vijim i një procesi shumëpalësh të filluar me

9. Objektivi strategjik 3 i Strategjisë afatmesme është ndërtimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe paqësore, përfshirë edhe nxitjen e lirisë së shprehjes. Objektivi strategjik 4 është ndërtimi i një mjedisi teknologjik në shërbim të njerëzimit nëpërmjet zhvillimit dhe përhapjes së dijeve, aftësive dhe standarteve etike. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000378083>.

10. Unesco, "Internet Universality Indicators." (Treguesit Universalë të Internetit). <https://www.unesco.org/en/internet-universality-indicators>.

11. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2015/. "Dokumenti përfundimtar i nivelit të lartë të Asamblesë së Përgjithshme për një rishikim të plotë të zbatimit të Samitit Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit". 70/125. [https://unctad.org/system/files/official-document/ares70d125\\_en.pdf](https://unctad.org/system/files/official-document/ares70d125_en.pdf).

kremtimin botëror të Ditës së Lirisë së Shtypit në majin e këtij viti.<sup>12</sup> Deklarata pohon se informacioni është një e mirë publike dhe, mes qëllimeve të tjera, përcakton tre hapa për garantimin e informacionit si një burim i përbashkët për tërë njerëzimin: transparenca e reformave digjitale, fuqizimi i qytetarëve nëpërmjet zotësisë në përdorimin e informacionit dhe qëndrueshmërisë së mediave. Në procesin e nxitjes së vizionit të informacionit si e mirë publike, UNESCO pranon se kjo e drejtë universale është njëkohësisht mjet dhe qëllim për përmbushjen e aspiratave të përbashkëta njerëzore, duke përfshirë edhe Agjendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Informacioni i mbështet qytetarët të ushtrjnë të drejtat e tyre themelore, të mbështesin barazinë gjinore dhe kontribuon për pjesëmarrjen, besimin në qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke mos lënë askënd pas.

- 16.** Theksi që Udhëzuesit vendosin mbi sfidat, të cilat lidhen me lirinë e shprehjes dhe mundësinë e përdorimit të informacionit dhe përmbajtjeve kulturore të ndryshme në mjedisin digjital, plotëson punën e Organizatës në fushat e arsimit, shkencës dhe kulturës. Kjo përfshin edhe Rekomandimet e UNESCO-s mbi Etikën e Inteligjencës Artificiale<sup>13</sup> por pa u kufizuar në të dhe bën thirrje për politika ndërkombëtare dhe kombëtare për një kuadër rregullator, i cili të garantojë përfitimin prej teknologjive të reja nga njerëzit në tërësi. Po ashtu në të përfshihet edhe *Konventa mbi Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Shprehjeve Kulturore të 2005*<sup>14</sup> dhe “Udhëzuesi mbi zbatimin e Konventës mbi Hapësirën Digjitale”. Ky Udhëzues, nxit “respektin” për lirinë themelore të shprehjes, informimit, komunikimit, privatësisë dhe të drejta të tjera të njeriut, si parakushte për krijimin, përhapjen dhe mundësinë e përdorimit të shprehjeve të ndryshme kulturore, duke përfshirë edhe lirinë artistike si një pasojë e pashmangshme për lirinë e shprehjes, të drejtat sociale dhe ekonomike të autorëve e artistëve, që punojnë në mjedisin digjital dhe në ndërlidhjen e tërë partnerëve mes tyre e sipas zgjedhjeve të tyre.<sup>15</sup> Lënda e Udhëzuesit përbën edhe një plotësim të Deklaratës MONDIACULT-2022, e cila bën thirrje për një “rregullim thelbësor të sektorit digjital, veçanërisht të platformave kryesore” në dobi të larmisë kulturore dhe mundësisë së barabartë të përdorimit të tyre nga të gjithë”.<sup>16</sup>

12. UNESCO, *Deklarata Windhoek+30* e 2021: Informacioni si e mirë publike <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000378158>.

13. UNESCO, 2021. “Rekomandime për Etikën e Inteligjencës Artificiale: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000380455>.”

14. UNESCO 2005. *Konventa mbi Mbrojtjen dhe Nxitjen e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore*. <https://en.unesco.org/creativity/convention>.

15. UNESCO.2017. “Udhëzime mbi zbatimin e Konventës së Mjedisit digjital”. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000370521.page=92>.

16. UNESCO.2022. “UNESCO, Konferenca mbi Politikat Kulturore dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm - MONDIACULT 2022 - Deklarata përfundimtare”. [https://www.unesco.org/sites/default/files/medias/fichiers/2022/10/6.MONDIACULT\\_EN\\_DRAFT%20FINAL%20DECLARATION\\_FINAL\\_1.pdf](https://www.unesco.org/sites/default/files/medias/fichiers/2022/10/6.MONDIACULT_EN_DRAFT%20FINAL%20DECLARATION_FINAL_1.pdf).



# Guidelines

## Struktura e Udhëzuesit

- 17.** Udhëzuesi fillon me përshkrimin e mjedisit që duhet krijuar për të mbrojtur lirinë e shprehjes, mundësinë e përdorimit të informacionit dhe të drejta të tjera të njeriut, çka kërkon një mjedis të hapur e të sigurt në platformat digjitale, si për sa u takon përdoruesve ashtu edhe jo përdoruesve të tyre. Udhëzuesi nxjerr në pah përgjegjësitë e palëve të ndryshme në këtë drejtim. Këto përfshijnë:
  - a.** Detyrimet nga ana e shteteve për respektimin, mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut.
  - b.** Përgjegjësitë e platformave digjitale në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut.
  - c.** Rolin e organizatave ndërqeveritare.
  - d.** Rolin e shoqërisë civile, mediave, komuniteteve të teknikëve dhe akademikëve, si edhe të pjesëmarrësve të tjerë për nxitjen e të drejtave të njeriut.
- 18.** Udhëzuesi përcakton më tej parimet bazë të sistemit të administrimit të platformave digjitale nëpërmjet një qasjeje shumëpalëshe e të bazuar në të drejtat e njeriut. Ky kapitull përcakton vetërregullimin komplementar, bashkërregullimin, ndreqjet rregullatore statutore, si edhe kriteret të cilat duhen përdorur në lidhje me përcaktimin e fushëveprimit të kompanive mbi bazën e rregullimeve statutore.
- 19.** TMë tej, udhëzuesi identifikon edukimin mediatik e informues dhe respektin ndaj diversitetit kulturor, si një përgjegjësi e përbashkët për të gjitha palët e përfshira

në administrimin e platformave digjitale.

- 20.** Së fundmi, Udhëzuesi përshkruan fushat ku platformat digjitale duhet të ndërtojnë sisteme dhe të ndërmarrin procese për vlerësimin e riskut; të kujdesen dhe të moderojnë përmbajtjen bazuar në standardet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe respektimin e diversitetit kulturor siç përcaktohet në Konventën UNESCO 2005; të aftësojnë më tej përdoruesit nëpërmjet mediave dhe edukimin mediatik dhe informues; të marrin përgjegjësi nëpërmjet mekanizmave të sinjalizimit dhe ndreqjeve, në mënyrë që të mbrohet liria e shprehjes, mundësia e përdorimit të informacionit dhe të tjera të drejta të njeriut.
- 21.** Është me rëndësi të theksohet se fushat e ndryshme që mbulon ky Udhëzues (siç përcaktohet në paragrafët 17-21 ) duhet të konsiderohen si një e tërë. Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe mundësia e përdorimit të informacionit dhe e përmbajtjeve të ndryshme kulturore kërkon marrjen në konsideratë të gjithë elementëve të përshkruar më lart.



## Krijimi i mjedisit

22. Të gjithë pjesëmarrësit ndajnë përgjegjësinë për mbështetjen dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për lirinë e shprehjes, për mundësinë e përdorimit të informacionit dhe të drejtave të tjera të njeriut, duke krijuar garancitë për një mjedis të hapur e të sigurt, si në lidhje me përdoruesit e platformave digjitale, ashtu edhe me jo-përdoruesit.<sup>17</sup>
23. Krijimi i një mjedisi funksional nuk është çështje me natyrë thjesht inxhinierike. Veç të tjerash, këtu bëhet fjalë për një përpjekje, e cila kërkon angazhim të shoqërive në tërësinë e tyre e, si rrjedhojë kërkon zgjidhje nga e tërë shoqëria. Të gjitha palët me rëndësi në të gjitha sistemet e administrimit duhet të vihen në lëvizje për të mundësuar ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes për grupet e cënueshme dhe të marginalizuara, grave dhe vajzave, komuniteteve indigjene, si edhe të gazetarëve, artistëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut e mbrojtësve të mjedisit. Të gjithë pjesëtarët e shoqërisë duhet të luajnë rolin e tyre për krijimin e një interneti të sigurt, në përballjen me veprimtaritë dëmtuese, të respektojnë të drejtat e të tjerëve gjatë këmbimeve online; të respektojnë diversitetin e përmbajtjeve kulturore dhe të jenë të ndërgjegjshëm për kritikën e qenësishme nga ana e shoqërive.
24. Fëmijët gëzojnë një status të veçantë, duke u nisur pikërisht nga faza e veçantë e zhvillimit të tyre, kufizimit apo mungesës së zërit në politikë dhe faktit se eksperiencat negative në fëmijëri mund të kenë pasojë për gjithë jetën ose dhe të trashëgohen

17. Fjalët "siguri" dhe "i sigurt" në këtë Udhërrëfyes konceptohen si kushtet ku individët kanë mundësinë të besojnë se të drejtat e tyre të njeriut - duke përfshirë edhe lirinë e shprehjes dhe mundësinë e përdorimit të informacionit - janë të mbrojtura.



ndër breza.<sup>18</sup> Në këtë prizëm, në sistemet e administrimit, përveç mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe mundësisë së përdorimit të informacionit nga individët, qeveritë dhe platformat digjitale, duhet gjithashtu të merren edhe përgjegjësi konkrete për sa u takon fëmijëve.<sup>19</sup> Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'u përmbahen standardeve të larta etike dhe profesionale, kur bëhet fjalë për angazhimin e fëmijëve në hapësirën digjitale, përfshirjen, mbrojtjen dhe nxitjen e lirisë së shprehjes së fëmijëve e po ashtu edhe të mundësisë së përdorimit të informacionit.

25. Të gjitha palët e përfshira në administrimin e platformave digjitale duhet të inkurajojnë dhe kur është e mundur edhe t'u japin përgjigje bashkëpunuese - nëpërmjet përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile, rrjeteve të gazetarëve dhe studiuesve - për të përfutur dije më të detajuara në lidhje me atë përmbajtje, e cila do të jetë objekt kufizimi në përputhje me ligjet dhe standardet e të drejtave të njeriut; duhet të mbrojnë e të mbështesin gratë dhe vajzat, grupet në rrethana të cenueshme dhe të marginalizuara, gazetarët, artistët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, komunitetet e indigjenëve dhe mbrojtësit e mjedisit.

## Detyrimet e shteteve për respektimin, mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut

26. Shtetet duhet të respektojnë dhe të nxisin të drejtat e njeriut, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për lirinë e shprehjes dhe mundësinë e përdorimit të informacionit. Kufizimet e lirisë së shprehjes janë të lejueshme vetëm në kuadrin e kushteve të përcaktuara nga Neni 19 (3) dhe 20 i ICCPR. Shtetet kanë detyrime konkrete për të mbrojtur të drejtat e njeriut ndaj ndërhyrjeve të pajustificuara të aktorëve privatë, duke përfshirë edhe platformat digjitale, ashtu siç kanë edhe përgjegjësinë të krijojnë një mjedis rregullator, i cili mundëson respektimin e të drejtave të njeriut nga ana e platformave digjitale dhe, nga ana tjetër, t'u ofrojnë këtyre të fundit udhëzime në lidhje me përgjegjësitë e tyre.
27. Veç kësaj, shtetet kanë detyrimin të jenë plotësisht transparente dhe të përgjegjshme në lidhje me kërkesat që u paraqesin platformave digjitale, duke garantuar siguri ligjore dhe siguri të përfshirjes ligjore, të cilat janë parakushte thelbësore për sundimin e ligjit.
28. Konkretisht, shtetet duhet:

18. Shih Kombet e Bashkuara, Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve (2013), "Komente të përgjithshme n 16 (2013) mbi Detyrimet e shtetit në lidhje me ndikimet e sektorit të biznesit në të drejtat e fëmijëve". <https://www.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/general-comment-no-25-2021-childrens-rights-relation>.

19. Më së shumti fëmijë konsiderohen personat nën moshën 18 vjeç.

- a. Të nxisin mundësinë për një përdorim universal dhe domethënës të internetit, si edhe të garantojnë neutralitetin e rrjetit.<sup>20</sup>
- b. Të mundësojnë që gjithë fëmijët të kenë mundësi të barabarta dhe reale të përdorimit të hapësirës digjitale në mënyra të plota për ta dhe të marrin masat e nevojshme për të kapërcyer përjashtimin digjital.<sup>21</sup>
- c. Të orientojnë burimet dhe të përshpejtojnë përpjekjet në mënyrë që të eliminojnë ndasitë digjitale, të plotësojnë mangësitë në lidhje me të dhënat, të heqin barrierat me të cilat përballen grupet e cenueshme dhe të marginalizuara, të përmbushin të drejtën e grave dhe vajzave për të përdorur internetin.
- d. Të forcojnë hapësirën qytetare e të nxisin median e lirë, të pavarur dhe pluraliste dhe të mbështesin kërkimet e pavarura për sa i takon shprehjeve të përdorura në rrjet, shqyrtimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes si edhe kontrollin e platformave.
- e. Të garantojnë mbrojtje të fortë të gazetarëve, (përfshi edhe gratë gazetare), të mbrojtësve dhe protestuesve për të drejtat e njeriut dhe të marrin në konsideratë mbështetjen e mekanizmave transparentë vetërregullues nga ana e mediave, të cilat nxisin dhe mbrojnë standardet më të larta të profesionalizmit.
- f. Të garantojnë mbrojtje të fortë për artistët, duke pranuar rëndësinë e punës së tyre në lidhje me përtëritjen e prodhimit kulturor dhe nxitjen e diversitetit kulturor dhe të kenë parasysh se ata qëndrojnë në themel të indit kulturor të shoqërisë.
- g. T'u garantojnë përdoruesve të platformave digjitale të drejtën e lirisë së shprehjes, mundësinë e përdorimit të informacionit, barazinë, mos-diskriminimin, si edhe të mbrojnë të drejtat e përdoruesve për privatësi e për ruajtjen e të dhënave, si edhe të drejtën e organizimit në shoqata dhe atë të pjesëmarrjes në jetën publike.
- h. Të miratojnë ligje të bazuara në standardet e të drejtave ndërkombëtare dhe të mundësojnë zbatimin efektiv të tyre për të ndaluar, hetuar dhe ndëshkuar dhunën gjinore në rrjet.<sup>22</sup>
- i. Të mundësojnë që të gjitha kufizimet ndaj platformave t'i referohen në mënyrë të vazhdueshme një pragu të një niveli të lartë për kufizimet e lirisë së shprehjes të bazuara në zbatimin e Neneve 19 (3) dhe 20 të ICCPR, duke respektuar kushtet e ligjshmërisë, objektivave legjitimë, nevojës dhe proporcionalitetit.

20. Te "Deklarata e Përbashkët mbi Lirinë e Shprehjes në Internet" mandatet speciale mbi lirinë e shprehjes: "Realizimi konkret i të drejtës për lirinë e shprehjes u dikton shteteve detyrimin për të nxitur mundësinë universale të përdorimit të internetit" Miratuar më 1 qershor 2011, paragrafi 6 (a). <http://www.law-democracy.org/wp-content/uploads/2010/07/11.06.Joint-Declaration.Internet.pdf>.

21. Shiko "Komente të përgjithshme n.25 (2021) mbi të drejtat e fëmijëve në lidhje me mjedisin digjital" <https://www.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/general-comment-no-25-2021-childrens-rights-relation>.

22. Shih A/76/258: Drejtësia gjinore dhe liria e shprehjes - Raport i Raportuesit të posaçëm mbi nxitjen dhe mbrojtjen e lirisë së opinionit dhe shprehjes "Të gjitha masat ligjore për kufizimin e fjalëve që nxisin urrejtjen gjinore apo që çojnë në dezinformim duhet të pajtohen me tri kriteret themelore: ligjshmëri- domosdoshmëri- përpjesëtim dhe të legjitimohen objektivat ashtu siç përcaktohen në Nenin 19 (3) të Konventës. Kriminalizimi duhet të shmanget, përveç se në rastet më flagrante kur mbrojtja përbën nxitje". <https://www.ohchr.org/en/documents/thematic-reports/a76258-gender-justice-and-freedom-expression-report-special-rapporteur>.

- j.** Të shkruajonë fuqimisht - duke përfshirë edhe masa të tilla si kodet profesionale të sjelljes - zyrtarët publikë nga përhapja e dezinformimit, përfshi edhe dezinformimin gjinor<sup>23</sup>- keqinformimin, trembjen apo kërcënimin e mediave. Veç kësaj, të ndalojnë shprehjet që kontribuojnë në shtimin e urrejtjes kombëtare, gjinore, racore apo fetare e që përbëjnë nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë, të cilat janë të ndaluar nga ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut e të jenë në përputhje me Strategjinë e Kombeve të Bashkuara dhe Planin e Veprimit në lidhje me gjuhën e urrejtjes.
- k.** Të jenë transparentë dhe të mos pajtohen me asnjë pretendim nga ana e platformave digjitale për të dhënë informacion në lidhje me natyrën, numrin dhe bazën ligjore, kur u kërkohet të fshijnë, të heqin dhe bllokojnë përmbajtje. Shtetet, duhet të jenë po ashtu në gjendje të tregojnë se sa e tëra kjo është në përputhje me Nenet 19 (3) dhe 20 të ICCPR-s.
- l.** Të nxisin edukimin mediatik dhe informues për të thelluar angazhimin pozitiv së bashku me platformat, në mënyrë që të rrisin aftësitë për rrjet të sigurt, duke angazhuar në hapësirat digjitale përdoruesit, veçanërisht ata të grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara me synim aftësimin e tyre. Kjo duhet të përfshijë nxitjen e njohurive në lidhje me të drejtat ndaj lirisë së shprehjes, të privatësisë, barazisë, mundësisë për t'iu drejtuar sistemit të drejtësisë dhe thellimit të njohurive mbi mjetet për ankim ligjor dhe korrigjim, si edhe mundësisë së mbështetjes në shqyrtime të ekspertëve të mediave, të informimit, punonjësve të bibliotekave, akademikëve, organizatave të shoqërisë civile dhe të mundësisë së përdorimit të institucioneve të informimit.
- m.** Të bëjnë të mundur që të gjitha autoritetet rregulatore të përfshira në administrimin e përmbajtjes së platformave digjitale, pavarësisht tematikave të këtyre të fundit, të jenë të strukturuar, të pavarura, të mbrojtura nga interesat politike dhe ekonomike, si edhe të kenë sisteme kontrolli të jashtëm (shih paragrafët 68-73 të këtij Udhëzuesi). Një sistem i tillë kontrolli mund të përfshijë shqyrtim juridik e ligjor, kërkesë për transparencë e këshillim shumëpalësh, raportim vjetor dhe të qenit subjekt i auditimeve të jashtme periodike. Kjo gjithashtu përfshin edhe përcaktimin e normativave të qarta në lidhje me kompetencat dhe autoritetin e institucioneve të gjyqësorit.
- n.** T'u mundësohen autoriteteve rregulatore burimet dhe kapacitetet e mjaftueshme për të kryer vlerësimin në përputhje me objektivat e këtij Udhëzuesi.
- o.** Të pranojë që çdo sistem qeverisës duhet t'i drejtohet për shqyrtim ekspertëve të të drejtave të njeriut, akademikëve dhe organizatave të shoqërisë civile, si edhe

23.Ide, pj.21: "Dezinformimi gjinor është gjithashtu në rritje. Si nënkategori e dhunës gjinore, ky shfaq disa tipare dalluese, si "përdorimi i narrativave të rreme apo çorientuese gjinore dhe seksuale kundër grave, e që shpesh karakterizohen nga një shkallë e caktuar koordinimi e që kanë për synim frenimin e pjesëmarrjes së grave në sferën publike. Këtu vërejmë kombinimin e tri veçorive caktuara të dezinformimit në rrjet: falsitetin, dashaligjësinë dhe koordinimin.

të pranojë praktikat e mira nga sisteme të tjera qeverisëse.

- p. Të inkurajojë bashkëpunimin ndërkombëtar, përfshi këtu edhe bashkëpunimin përfshirës jug-jug, mes autoriteteve rregullatorë dhe aktorëve gjyqësorë, të nxisë këmbimin e praktikave dhe njohurive të mira.

**29.** Shtetet nuk duhet:

- a. Të diktojnë masa, të cilat parandalojnë apo dëmtojnë përdorimin e përgjithshëm të përhapjes së informacionit në rrjet dhe jo në rrjet, përfshi këtu edhe fikjen e internetit.
- b. Të diktojnë mbikëqyrje të përgjithshme apo detyrime të përgjithshme ndaj platformave digjitale e të marrin masa proaktive në lidhje me përmbajtjen e konsideruar joligjore në një juridiksion të caktuar apo të përmbajtjeve të cilat mund të kufizohen nga ligjet dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Platformat digjitale nuk duhet të konsiderohen përgjegjëse kur veprojnë në mirëbesim dhe tregojnë kujdesin e duhur, kur kryejnë investigime të vullnetshme apo marrin masa të tjera, të cilat kanë për qëllim zbulimin, identifikimin, heqjen apo çaktivizimin e atyre përmbajtjeve, të cilat ndalohen nga Nenet 20 të ICCPR apo që ka qenë nën kufizim në bazë të Nenit 19 (3) të ICCPR.
- c. Të kthejnë në subjekt gjobash penale personelin e platformave digjitale për shkelje të hamendësuar apo të mundshme të rregullave gjatë punës së tyre, për kontrollin dhe kujdesin e përmbajtjes.

## Përgjegjësitë e platformave digjitale kundrejt respektimit të të drejtave të njeriut

**30.** Platformat digjitale duhet të ndjekin pesë parime themelore:

- a. **Platformat digjitale tregojnë kujdesin e duhur kundrejt të drejtave të njeriut,** nëpërmjet vlerësimit të impaktit të këtyre të drejtave, duke përfshirë edhe aspektet gjinore dhe kulturore, vlerësimin e rrezikut dhe përcaktimin e masave zbutëse.
- b. **Platformat u përmbahen standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë në kornizat e tyre shqyrtimin dhe kujdesin ndaj përmbajtjes.** Platformat duhet të ndjekin standardet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshi edhe Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Sipërmarrjen dhe të Drejtat e Njeriut. Objektivat duhet të mos jenë diskriminues, të synojnë një trajtim të barabartë dhe të parandalojnë dëmtimin; shqyrtimi i përmbajtjes, politikat dhe praktikat e kujdesshme duhet të jenë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, edhe kur funksionimi kryhet nëpërmjet mjeteve të automatizuara

apo njerëzore, të njohin gjuhët dhe kontekstin gjuhësor vendor e, gjithashtu të tregojnë respekt për diversitetin kulturor e të japin mbrojtje të përshtatshme dhe mbështetje për punonjësit.

**c. Platformat janë transparente dhe të hapura për sa i takon mënyrave të punës, me politika të kuptueshme dhe të kontrollueshme e gjithashtu edhe me kontrole shumëpalëshe për vlerësimin e aktivitetit. Kjo përfshin transparencën ndaj mjeteve, sistemeve dhe proceseve që përdoren për moderimin dhe kujdesin e përmbajtjes në platformat e tyre, përfshi edhe kujdesin ndaj vendimeve të algoritmeve dhe rezultateve që ato prodhojnë.**

**d. Platformat ofrojnë informacion të disponueshëm për përdoruesit në mënyrë që këta të kuptojnë produktet, shërbimet dhe mjetet e ndryshme të përdorura në to, që të marrin vendime duke qenë të informuar në lidhje me përmbajtjen që ndajnë dhe konsumojnë. Platformat ofrojnë informacion dhe mundësojnë përdorimin në gjuhët e përdoruesve, duke marrë parasysh moshën dhe paafësitë e tyre.**

**e. Platformat janë përgjegjëse ndaj palëve kryesore – përfshi përdoruesit, publikun dhe aktorët e sistemit administrues – për sa i takon zbatimit të kushteve të shërbimit dhe politikave të përmbajtjes. Ato u japin përdoruesve mundësinë të kërkojnë rishikimin e duhur dhe në kohë ndaj vendimeve që lidhen me përmbajtjen, duke përfshirë, si ata përdorues, të cilëve u është hequr apo kontrolluar përmbajtja, ashtu edhe atyre, të cilët kanë ankesa ndaj përmbajtjes.**

**31.** Platformat duhet të zbatojnë parimet e çdo juridiksioni ku veprojnë, duke garantuar burimet dhe kapacitetet për t’iu shërbyer në kohë dhe me efikasitet përdoruesve.

**32.** Për të vënë në zbatim këto parime, ekzistojnë sfera konkrete ku çdo platformë digjitale ka përgjegjësinë të raportojë apo të ndërveprojë me aktorët pjesëmarrës në sistemin e administrimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Këto sfera përshkruhen në paragrafët 85-129 të këtij Udhëzuesi.

## Roli i organizatave ndërqeveritare

**33.** Organizatat ndërqeveritare, në përputhje me mandatet përkatëse, duhet të mbështesin palët kryesore për garantimin dhe zbatimin e këtij Udhëzuesi, në mënyrë që të jenë në përputhje të plotë me ligjet dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo mbështetje duhet të përfshijë ofrimin e asistencës teknike, monitorimin dhe raportimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, arritjen e standardeve kryesore, mundësimin e dialogut shumëpalësh dhe edukimin e rrjeteve.

**34.** Organizatat ndërqeveritare dhe agjencitë rregullatore kombëtare duhet të krijojnë modalitetet e nevojshme në lidhje me angazhimin për zhvillimin e mëtejshëm dhe

shfrytëzimin e praktikave pozitive. Një angazhim i tillë duhet të përfshijë njohuritë e reja dhe prirje rregullatore, si edhe mbështetjen dhe sugjerimet ndaj rregullatorëve kombëtarë, në mënyrë që këta të përsosin standardet institucionale dhe metodat për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe mundësisë së përdorimit të informacionit. Modalitete të tilla duhet të synojnë reduktimin e rrezikut të fragmentarizimit të internetit, si edhe të ofrojnë mjete, të cilat mundësojnë një vlerësim paraprak të efektit rregullator në lidhje me funksionimin e internetit si një i tërë.

## Roli i shoqërisë civile dhe palëve të tjera

- 35.** Të gjitha palët e angazhuara në shërbimet e platformave digjitale, si përdoruesit, politikëbërësit, “watchdog”-ët e gjithkush tjetër, kanë rol jetik për të luajtur në lidhje me mbështetjen e lirisë së shprehjes, mundësisë së përdorimit të informacionit dhe të drejtave të tjera të njeriut. Për këtë qëllim, procesi i zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të rregullimit që prek përmbajtjen e platformave digjitale, duhet të ketë një qasje shumëpalëshe. Në procesin e mbikëqyrjes duhet të angazhohet një kuadër i gjerë palësh, duke përfshirë edhe ato që përfaqësojnë grupe të cenueshme dhe të marginalizuara, gazetarët, artistët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe mbrojtësit e mjedisit.
- 36.** Shoqëria civile luan një rol kritik për të kuptuar natyrën e përmbajtjeve dhe sjelljeve të dëmshme në rrjet, të cilave duhet t’u kundërvihen sidomos atyre që drejtohen ndaj grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara, grave dhe vajzave, gazetarëve, artistëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe mbrojtësve të mjedisit. Shoqëria civile gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe denoncimin e ligjeve, politikave dhe veprimtarisë rregullatore të qeverisë, të cilat prekin të drejtat e njeriut. Ato janë thelbësore në mbushjen e hapësirave të mangëta mes ekosistemit të administrimit digjital dhe njerëzve në përgjithësi.
- 37.** Studiuesit e pavarur luajnë rol në identifikimin e modeleve të sjelljeve abuzive dhe kur është e mundur shkulin rrenjë të shkaqeve që duhen trajtuar; kërkuesit duhet të jenë gjithashtu të aftë të ofrojnë kontroll të pavarur në lidhje me mënyrën se si punon sistemi i administrimit. Institucionet e pavarura dhe kërkuesit mund të mbështesin kujdesin e duhur ndaj të drejtave të njeriut, duke përfshirë vlerësimin gjinor, auditimin, hetimin dhe tipe të tjera denoncimi në lidhje me praktikën dhe veprimtarinë e platformave. Kërkuesit duhet të jenë në gjendje të mbledhin dhe të analizojnë të dhënat e shpërndara për sa i përket gjinisë dhe faktorëve të tjerë me rëndësi që kryqëzohen gjatë procesit (si raca, etnia, moshë, statusi socioekonomik, paaftësia, etj.). Kjo ndihmon në identifikimin e pabarazive, paragjykimëve dhe impakteve të ndryshme të platformave digjitale ndaj grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara.
- 38.** Kompanitë mediatike, organizatat faktmbledhëse dhe profesionale brenda këtyre

institucioneve janë palë të rëndësishme dhe luajnë rol në nxitjen dhe shijimin e lirisë së fjalës, mundësisë së përdorimit të informacionit dhe të të drejtave të tjera të njeriut, duke ushtruar funksionin e tyre si vëzhguese. Kësisoj, nevojitet që media dhe profesionistët e saj të përfshihen në proceset rregullatore, duke qenë të vetëdijshme për rolin e tyre si pjesëmarrëse aktive e me kontribut pozitiv në ekosistemin e informacionit digjital. Një marrëdhënie konstruktive ndërmjet platformave digjitale dhe burimeve të besueshme të reja do të forcojë rolin e platformave digjitale në ofrimin e një informacioni në interes të publikut.

39. Edukatorët dhe kujdestarët luajnë një rol të rëndësishëm në ndihmën ndaj të rinjve dhe nxënësve të të gjitha moshave, në mënyrë që të kuptojnë një mjedis të zgjeruar digjital, duke përfshirë edhe mënyrën se si të shikojnë dhe të kuptojnë informacionin e besueshëm dhe si të komunikojnë me respekt ndaj personave të tjerë në rrjet. Ata luajnë gjithashtu rol në ofrimin e mësimdhënies si një proces jetësor duke qenë se teknologjia ndryshon me shpejtësi.
40. Inxhinierët, shkencëtarët e të dhënave dhe komunitetet e teknikëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të platformave, ushtrojnë rolin e tyre për sa i përket kuptimit të duhur të të drejtave të njeriut, rreziqeve, efekteve etike të produkteve dhe shërbimeve që ata ideojnë dhe realizojnë.<sup>24</sup>
41. Të gjitha palët duhet të luajnë rol aktiv nëpërmjet këshillimeve për sa i përket zhvillimit dhe funksionimit të sistemit të administrimit. Duhet ushqyer bashkëpunimi dhe dialogu mes palëve. Diskutimet konstruktive dhe vendimet duhet të përfshijnë shkëmbimin e ideve, njohurive dhe perspektivave. Krijimi i grupeve të punës, task forcave, apo komiteteve këshilluese ofron mundësi për pjesëmarrje aktive në formësimin e propozimeve rregullatore.

---

24. Shiko raportin e OHCHR-së mbi marrëdhëniet ndërmjet kuadrit të standarteve teknike dhe të drejtave të njeriut, A/HRC/53/42



## Sistemi i administrimit

42. Ekosistemi i administrimit digjital në gjithë botën bazohet në ekzistencën e palëve, organizmave dhe sistemeve rregullatore. Ndërkohë që disa sisteme administruese ekzistuese, si në rastin e zgjedhjeve apo të ruajtjes së të dhënave, duhet të interpretohen në përputhje me ndryshimet dhe sfidat që sjell epoka digjitale, në kontekste të ndryshme krijohen sisteme të reja drejtimi për rregullimin e drejtpërdrejtë të platformave digjitale. Sidoqoftë, këto mekanizma rregullatore mund të sjellin pasoja të mëdha për lirinë e shprehjes dhe mundësinë e përdorimit të informacionit dhe përmbajtjeve të ndryshme kulturore në rrjet.
43. Ky Udhëzues thekson parimet gjithëpërfshirëse, të cilat mund të vihen në zbatim, si edhe proceset e ndryshme kryesore, të cilat lidhen me administrimin e përmbajtjes në platformat digjitale, pavarësisht formës apo fushës së tyre. Kjo tregon se një sistem administrimi gjithëpërfshirës, mund të vërë me efikasitet në funksionim masa të ndryshme rregullatore plotësuese për të trajtuar sfidat, me të cilat përballen palë të ndryshme në ekosistemin digjital.
44. Udhëzuesi fton për një qasje shumëpalëshe në administrimin e platformave digjitale. Kjo qasje duhet të përfshijë aspekte të tilla si: identifikimi i palëve me rëndësi (përfshi këtu edhe platformat që futen brenda objektivave), inkurajimi i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse, mundësimi i përfaqësimit të balancuar, mundësimi i transparencës dhe përgjegjësisë, nxitja e vendimmarrjes nëpërmjet bashkëpunimit dhe dialogut, mundësimi i proceseve të përsëritura, koordinimi i përpjekjeve të palëve gjatë fazave të zbatimit, si edhe kryerja e vlerësimeve dhe rishikimeve periodike.
45. Në varësi të kontekstit, mekanizmat e përgjegjësisë dhe miratimit për administrimin



e platformave digjitale mund të përfshijnë plotësime dhe konvergjenca në kuadrin e masave rregullatore, konkretisht si më poshtë:

- a. **Struktura dhe mekanizma vetërregullues atje ku rregullat mund të mbikëqyren dhe të zbatohen nga aktorë jo shtetërorë, si organizma mbarëindustrialë apo këshilla të mediave sociale.**
- b. **Struktura dhe mekanizma bashkërregullatorë, në rastet kur kodet e sjelljes mund të konsiderohen si forcë ligjore, e cila shërben si rregullator.**
- c. **Kuadri rregullator statutor, ku një apo më tepër rregullatorë të pavarur marrin vendime përfundimtare në përcaktimin e rregullave të platformave.**

46. Ky Udhëzues, duke pranuar kompleksitetin e kësaj fushe, synon të zbatojë një shkallë të gjerë formash administrimi. Është me rëndësi të shënohet se kuadri rregullator statutor, mund të jetë i nevojshëm në disa fusha për adresimin e sferave të papërshtatshme për mekanizmat vetërregullues dhe bashkërregullues. Një kuadër i tillë duhet të garantojë gjithnjë pavarësinë e autoriteteve zyrtare rregullatore dhe, në përputhje me objektivat e Udhëzuesit, duhet të ruajë gjithnjë të drejtat e njeriut.

## Parimet e sistemeve të administrimit

- 47. Së pari, **transparenca** duhet të jetë parim kryesor. Në të gjitha sistemet e administrimit, platformat digjitale duhet të jenë transparente në lidhje me kushtet, sistemet dhe proceset që përdorin, në mënyrë që të moderojnë dhe kurojnë përmbajtjen e platformave të tyre, si edhe të tregojnë tërë kujdesin e duhur ndaj të drejtave të njeriut në përputhje me dispozitat e këtij Udhëzuesi dhe të Parimeve Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara mbi sipërmarrjen dhe të drejtat e njeriut. Ato duhet të jenë në gjendje të shpjegojnë se si sistemet dhe proceset e tyre përmbushin kushtet e shërbimit dhe zbatimin efektiv të tyre dhe nëse janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
- 48. Sistemet e administrimit dhe procedurat jashtë platformave duhet të jenë gjithashtu transparente. Çdo veprim rregullator i jashtëm duhet të propozohet në mënyrë të hapur, të debatohet gjerësisht, e më pas t'i nënshtrohet këqyrjes publike, me përcaktime të hapëta dhe të qarta për sa i përket vendimeve në lidhje me mandatin dhe përgjegjësinë.
- 49. Së dyti, parimi rregullator i përbashkët është se **kontrolli dhe balancimi** ndërmjet interesave të ndryshme duhet të institucionalizohet zyrtarisht. Sistemet e administrimit duhet të kenë kurdoherë një qasje shumëpalëshe nëpërmjet të gjitha formave të rregullimit dhe kombinimeve të tyre. Kjo nënkupton arritjen e një pjesëmarrjeje të gjerë dhe përfshirëse mes të gjitha palëve, të cilat mund të përfaqësojnë më mirë

interesat dhe vlerat e ndryshme, duke përfshirë gjini të ndryshme dhe perspektiva ndërsektoriale. Pjesëmarrja shumëpalëshe duhet të jetë në përputhje me kushtet e përfaqësimit edhe për sa i përket krijimit, zbatimit, monitorimit dhe rishikimit të proceseve të administrimit (rregulla, parime dhe politika). Fushatat ndërgjegjësuere publike, synojnë respektin për diversitetin kulturor, përdorin një gjuhë përfshirëse dhe disponojnë formate në lidhje me proceset administruese, të cilat mundësojnë një pjesëmarrje efektive.

50. Së treti, proceset e administrimit duhet të jenë të **hapura dhe të shfrytëzueshme** nga të gjitha palët, veçanërisht nga grupet e përfshira dhe duhet të kryhen nëpërmjet strukturash të propozuara ose tipe rregullatore. Për ofrimin e mundësive në lidhje me kontributin dhe marrjen e opinionëve të publikut duhet të përdoren këshillimet publike, dëgjesa të hapura dhe platformat në rrjet. Gjatë proceseve të vendimmarrjes duhet të përfaqësohen në mënyrën e duhur shqetësimet e grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara, si edhe të grave e vajzave.
51. Sistemi i administrimit duhet t'u mundësojë platformave digjitale angazhimin aktiv ndaj fëmijëve, mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të drejtave të tjera të tyre, të zbatojë mbrojtjen e përshtatshme dhe t'u japë konsideratën e duhur këndvështrimeve të tyre në lidhje me produktet dhe shërbimet e ofruara.
52. Sistemet e administrimit duhet gjithashtu të nxisin dialogun me mediat, të përfshijnë investimet në mediat informative të pavarura, të mbështesin ekosistemin mediatik, duke i bërë të dhënat të jenë disponueshme dhe duke nxitur aksionet për thellimin e qëndrueshmërisë, diversitetit dhe pluralizmit të mediave.
53. Së katërti, përfshirja e **ekspertizave të ndryshme**, duhet të jetë tipar i përbashkët i të gjitha rishikimeve rregullatore. Sistemet e administrimit duhet të garantojnë që të gjitha palët të kenë kapacitetet e nevojshme, çka arrihet nëpërmjet trajnimit dhe zotërimit të instrumenteve rregullatore, në mënyrë që të kuptohet kuadri i të drejtave të njeriut dhe të merren parasysh zhvillimet teknologjike. Ato duhet të kenë kapacitetet dhe njohuritë teknike për të disponuar informacionin e duhur gjatë vendimmarrjes dhe të zbatojnë këtë Udhëzues. Të gjitha sistemet e administrimit duhet të inkurajohen që të raportojnë në publik dhe të kryejnë vlerësimin e rrezikut e të mundësive që lidhen me teknologjitë e reja dhe në fazë zhvillimi.
54. Palët pjesëmarrëse në sistemet e administrimit duhet të disponojnë ekspertizat dhe njohuritë rregullatore në kontakt me autoritetet. Sistemet e administrimit në nivel kombëtar, rajonal dhe global duhet të jenë të afta të ndajnë praktikata, në mënyrë që të përbushin qëllimet e mbrojtjes së lirisë së shprehjes, mundësisë së përdorimit të informacionit dhe të drejta të tjera të njeriut e, gjithashtu të trajtojnë përmbajtje të cilat mund të pësojnë kufizime të mundshme për shkak të ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

- 55.** Së pesti, sistemi i qeverisjes duhet të garantojë që platformat digjitale të angazhohen **në mbrojtjen dhe nxitjen e diversitetit kulturor dhe diversitetit të shprehjeve kulturore** për sa i përket krijimtarisë, shpërndarjes, përhapjes, aksesit dhe gëzimit të fryteve të të mirave kulturore dhe shërbimeve në rrjet, duke garantuar barazi përfqësimit dhe identifikimit.

## Përgjegjësi dhe përputhshmëri

- 56.** Rishikimet rregullatore duhet të jenë efektive e të qëndrueshme, të marrin parasysh burimet e disponueshme vendore dhe prioritetet kryesore që kanë nevojë për vëmendje (konkretisht rastet kur trajtohen çështje me rëndësi parësore, të cilat lidhen me zgjedhjet, shëndetin publik, reklamat, mbrojtjen e të dhënave etj.). Mbikëqyrjet e pavarura janë të nevojshme për të gjitha format e ndërhyrjeve rregullatore. Procesi i kryerjes së rregullimeve duhet të jetë i hapur, transparent dhe i bazuar në fakte.
- 57.** Platformat digjitale që konstatohen në mospërputhje me politikat e tyre apo ato që nuk arrijnë të përmbushin detyrimet për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe mundësisë së përdorimit të informacionit, në rastet e përmbajtjeve të cilat duhet të pësojnë kufizimet në bazë të ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut e në përputhje me pesë parimet e përshkuara në paragrafët 85-129, duhet të mbajnë përgjegjësi para organizmave kryesore të sistemit e administrimit dhe, në mënyrë të proporcionuar të jenë subjekt i zbatimit të masave e të procedurave të nevojshme të mbrojtjes.
- 58. Sistemet e vetërregullimit** duhet të jenë plotësuese dhe të konvergojnë me format e tjera rregullatore. Ato duhet të përfshijnë audite periodike të detyrueshme, të cilat u mundësojnë platformave digjitale përputhjen me kodet, politikat apo normat vetërregulluese. Këto audite nuk duhet të financohen drejtpërdrejt nga industria apo nga platforma digjitale individuale. Shpenzimet për veprimtari të tilla mund të mbulohen nga taksat ndaj këtyre platformave. Po ashtu, auditimi nuk duhet të kryhet nga asnjë person apo organizëm, i cili mund të jetë në konflikt interesi apo të ketë gjasa për diçka të tillë. Metodologjia dhe rezultatet e auditit duhet të jenë të disponueshme për komente nga ana e publikut.
- 59. Strukturat bashkërregulluese** duhet të ofrojnë një kuadër ligjor, i cili të mundësojë mjedisin e duhur për lirinë e shprehjes, mundësinë e përdorimit të informacionit dhe të drejta të tjera të njeriut. Në procesin e vetërregullimit, roli rregullator duhet të ndahet mes industrisë dhe palëve të tjera, si edhe mes qeverisë dhe autoriteteve apo organizmave të pavarura publike. Roli i autoriteteve publike të rëndësishme përfshin pranimin e skemës së bashkërregullimit, auditimin e proceseve, financimin e skemës (mundësisht nëpërmjet taksimit të platformave). Bashkërregullimi duhet të lejojë mundësimin e masave ndëshkuese nga agjencitë ligjzbatuese shtetërore si

për shembull gjobat, në rastet kur nuk janë arritur objektivat e miratuar.

- 60. Rregullimet staturore** të platformave digjitale, të cilat trajtojnë çështje që mund kenë ndikim në lirinë e shprehjes duhet të konsiderohen të vlefshme vetëm kur vendimmarrja nga ana e autoriteteve rregullatore të përfshira në zbatimin e tyre ka qenë e pavarur. Rregullime të tilla duhet të fokusohen te sistemet e kontrollit dhe kujdesit të përmbajtjes, më shumë se te përcaktimi i ligjshmërinë së fragmenteve të veçanta të saj. Nga ana tjetër, ato duhet të kenë bazë ligjore, (për shembull të jenë të përcaktuara qartë) të ndjekin objektiva të legjitimuar në bazë të artikullit 19 (3) të ICCPR, të jenë të nevojshme dhe të proporcionuara.
- 61.** Qasja shumëpalëshe në rregullimet staturore duhet të reflektohet me rishikime nëpërmjet:
  - a. Autoriteteve të rëndësishme shtetërore, duke përfshirë autoritetet rregullatore të pavarura publike, përcaktimin e objektivit legjitim të rregullimeve nëpërmjet proceseve legjislative pjesëmarrëse dhe përfshirëse.**
  - b. Platformat digjitale të raportojnë publikisht përpara autoriteteve rregullatore zyrtare.**
  - c. Organizatat e shoqërisë civile, artistët, studiuesit e pavarur dhe institucionet e tjera të rëndësishme, ofrojnë kontribut në hartimin e ligjeve, kontribuojnë për mbikëqyrjen, kryejnë kontrole për balancimet e nevojshme dhe shqyrtojnë veprimtarinë duke u përfshirë në mënyrë të institucionalizuar në proces.**
- 62.** Çdo vendim konkret në lidhje me ligjshmërinë e pjesëve të caktuara të përmbajtjes duhet të ndjekë proceset e duhura dhe të jetë i hapur ndaj vrojtimeve të paanshme dhe të pavarura të organeve gjyqësore.
- 63.** Në të gjitha rastet, vlerësimet në lidhje me përmbajtjen duhet të ndjekin tre kriteret e caktuara në lidhje me kufizimet e për ligjura të lirisë së shprehjes siç përmbahet në Nenin 19 (3) të ICCPR<sup>25</sup> dhe ndalimin e gjuhës së urrejtjes, e cila përbën nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë, siç përcaktohet në nenin 20 (2) të ICCPR; duhet të përfshijnë - në rast se është e zbatueshme - kuadrin gjashtë pikësh të përkufizimit të një përmbajtjeje të tillë, i cili është i përvijuar në Planin e Veprimit të Rabatit ).<sup>26</sup>
- 64.** Të gjitha ndërhyrjet për rregullime staturore duhet të bazohen në prova, të jenë të proporcionuara dhe të kryhen në përputhje me procedurat, duke u garantuar platformave akses në të gjitha faktet dhe vlerësimet ku është bazuar vendimi. Ky proces

25. UNESCO, 2021. "Kufijtë e për ligjur të Lirisë së shprehjes - Tre kriteret": <https://www.youtube.com/watch?v=W-g8fvTHPDag>.

26. UNESCO 2021. "Plani i Veprimit të Rabatit, mbi ndalimin e nxitjes së urrejtjes, Rabat." <https://www.unesco.org/archives/multimedia/document-5554-eng-3>.

duhet të përfshijë grupe shumëpalëshe, të marrë në konsideratë një panoramë më të gjerë në lidhje me qëndrueshmërinë, efikasitetin dhe efektin e ndërhyrjes. Parimi i një procesi të bazuar në prova nuk mund të përbëjë shkas për vonesa të veprimeve të nevojshme rregullatore në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

65. Të gjitha palët e rëndësishme, përfshi edhe platformat, duhet të kenë mundësinë të paraqesin vërejtje dhe/ose të apelojnë ndaj një vendimi, me të cilin nuk pajtohen. Sistemet rregullator, përpara se të zbatojë masa konkrete, duhet t'i kërkohet të bëjë publike apo të konsultohet në lidhje me zbatimin e masave detyruese, si edhe të ndjekë procesin e duhur përpara se të orientojë një platformë në lidhje me zbatimin e masave konkrete.

## Përcaktimi i platformave digjitale në kuadrin e rregullimeve

66. Gjatë procesit të përcaktimit të fushës së zbatimit të rregullimeve statutores të platformave digjitale, autoritetet rregullatore duhet të identifikojnë ato platforma, prania dhe përmasat e të cilave kanë një peshë të caktuar në një treg e në një juridiksion të caktuar. Këto duhet të përcaktohen nëpërmjet një vlerësimi të saktë dhe të pavarur të rrezikut që platformat paraqesin ndaj të drejtave të njeriut, ku duhet të përfshihen grupet e cenueshme dhe të marginalizuara, si edhe ndaj institucioneve demokratike.<sup>27</sup> Përcaktimi i fushës së veprimit duhet të mbrojë të drejtën për privatësi dhe të mos shpjerë në dobësimin e mbrojtjes së kriptimit dhe teknologjive të tjera të ruajtjes së privatësisë.
67. Në lidhje me reflektimin e realiteteve vendore dhe të juridiksioneve të ndryshme në identifikimin e kompanive, mund të merren parasysh kriteret e mëposhtme:
- a. **Përmasat dhe shtrirja**, ku fokusi vendoset tek platformat, të cilat kanë më tepër gjasa të kenë ndikim mbi një pjesë të rëndësishme të popullatës dhe/ose mbi grupe të cenueshme dhe të marginalizuara.
  - b. **Shtrirja në treg**, ku duhet pranuar ndikimi i konsiderueshëm i platformave mbizotëruese në gjithë ekosistemin e informacionit. Zbatimi i Udhëzuesit duhet të shmangë penalizimin e "start-up"-eve dhe aktorëve të rinj, por të veprojë te platformat digjitale me ndikim më të madh. Të gjitha platformat duhet të ndjekin parimet e përgjithshme dhe detyrimin për raportime konkrete në bazë paragrafëve 85-129 të këtij Udhëzuesi, por fillimisht procesi mund të përfshijë platformat më të mëdha, të cilat zotërojnë më tepër kapacitet për t'i vënë në jetë.
  - c. **Funksionaliteti dhe tipologjia**, ku merren parasysh dallimet e rëndësishme që shërbime të ndryshme kanë për sa i përket vizibilitetit, ndikimit dhe kahut të orientimit të përmbytjes. Rreziku mund të përcaktohet nga tipologjia e përdoruesve të platformës, format e pronësisë, modeli i sipërmarrjes, funksionaliteti dhe

27. Një udhërrëfyes shtesë për identifikimin e rrezikut sistematik të platformave mund të realizohet si bashkëshoqërues për funksionalizimin e këtij Udhëzuesi.

tipologjia, si postimet në kohë reale, potenciali për viralitet, vëllimi, shpejtësia e përhapjes, gjasat dhe shtrirja ku mund të postohet çdo përmbajtje pa proces kontrolli të saj.<sup>28</sup>



## Veçoritë e autoriteteve rregullore të pavarura

- 68.** Në rregulloren e parashikuar në ligj, entet rregullore zyrtare, ndonëse janë pjesë përbërëse e aparateve ekzekutive shtetërore, duhet të jenë tërësisht të pavarura nga qeveria dhe përgjegjëse kryesore përpara ligjit për përmbushjen e mandatit të tyre.<sup>29</sup> Kjo vlen për entet rregullore që kanë interes legjitim për përmbajtjen e platformave (si entet e organizimit të zgjedhjeve, agjencitë e reklamave, organet e mbrojtjes së fëmijëve, komisionet e të dhënave private, entet konkurruese, etj.), si edhe për çdo instancë tjetër rregulluese apo koordinuese, që mund të krijohet.
- 69.** Përsa i përket të gjitha enteve statutores të përfshira në rregullimin e platformave, veçmas ose në bashkëpunim, ato duhet t'i nënshtrohen një rishikimi periodik<sup>30</sup> i realizuar nga një organizëm i pavarur, i cili i përgjigjet drejtpërdrejt organit ligjvënës. Ndërhyrjet ligjore gjithashtu duhet të rishqyrtohen juridikisht, në qoftë se këto ente i kanë tejkaluar kufijtë e pushtetit të tyre, kanë vepruar në mënyrë të paarsyeshme, në mënyrë të njëanshme ose jo proporcionale.
- 70.** Autoritetet rregullore zyrtare duhet të jenë të pavarura dhe të lira nga presionet politike ose të çfarëdo presionesh të tjera. Pushteti dhe mandati i tyre duhet të përcaktohen me ligj. Gjithashtu, ato duhet të përputhen me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe të përkrahin standardet e barazisë gjinore.

28. "Rregullimet e riskut" bazohen në vlerësimet e kuadrit të normave /standardeve të rrezikut të rëndësishëm për objektivat e tyre si edhe të nivelit të duhur të ndërhyrjes në përputhje me nivelin e rrezikut. Nëse ndonjë nga aktorët ushtron veprimtari me rrezik të ulët, rregullimi duhet të kryhet në përputhje me efektet, duke ofruar kërkesa më të pakta për modifikim". [https://www3.weforum.org/docs/WEF\\_Pathways\\_to\\_the\\_Regulation\\_of\\_Crypto\\_Assets\\_2023.pdf](https://www3.weforum.org/docs/WEF_Pathways_to_the_Regulation_of_Crypto_Assets_2023.pdf).

29. Banka Botërore deklaroi se karakteristika kryesore e modelit të rregullatorit të pavarur është vendimmarrja në varësi. Një dokument udhëzues mbi rregullimin e transmetimit i porositur nga UNESCO (Salomon, Eve. Udhëzime për rregulloren e transmetimit. 2006) theksoi gjithashtu se "një autoritet i pavarur (domethënë ai që ka kompetencat e tij dhe përgjegjësitë e përcaktuara në një instrument të së drejtës publike dhe është i autorizuar të menaxhojë burimet e veta, dhe anëtarët e të cilit emërohen në mënyrë të pavarur dhe mbrohen me ligj nga shkarkimi i pajustificuar) është më mirë të veprojnë në mënyrë të paanshme në interes të publikut dhe për të shmangur ndikimin e padrejtë nga interesat politike ose të industrisë. Për referencën e plotë, shihni shtojcën e këtyre Udhëzimeve

30. Rishikimi duhet të vendosë theks të veçantë në mënyrën se si vendimet e sistemit rregullator mund të ndikojnë në gëzimin e të drejtave të njeriut.

- 71.** Institucionet zyrtare rregullatore duhet të kenë fonde dhe ekspertizë të mjaftueshme për të zbatuar në mënyrë të efektshme përgjegjësitë e tyre. Burimet e fondeve gjithashtu duhet të jenë të qarta, transparente dhe të mundësueshme për të gjithë dhe jo të përdoren për nevoja të administratës së tyre.
- 72.** Punonjësit e qeverisë ose anëtarët e institucioneve rregullatore zyrtare, që punojnë me çështjen e përmbajtjes së platformës duhet:
- a.** Të emërohen përmes një procesi pjesëmarrës, transparent, jo-diskriminues, të pavarur e të bazuar mbi meritën.
  - b.** Të përgjigjen përpara një organizmi të pavarur (i cili mund të jetë pushteti legjislativ, i drejtësisë, etj., një këshill i jashtëm ose një bord/borde i/të pavarur).
  - c.** Të përfshijnë ekspertizë lidhur me legjislacinin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe të ekosistemit digjital.
  - d.** T'i paraqesin një raport publik vjetor një enti të pavarur, në mënyrë ideale pushtetit legjislativ, të mbajnë përgjegjësinë para tij, si edhe duke informuar organizmin për opinionin e tyre të arsyetuar.
  - e.** Të bëjnë publik çdo konflikt interesi të mundshëm dhe të deklarojnë çdo dhuratë ose shpërblim.
  - f.** Pas mbarimit të mandatit, për një periudhë kohore të arsyeshme, nuk duhet të punojnë ose të ofrojnë shërbime me ente që kanë qenë subjekte të rregullimit të tyre, për të shmangur riskun e quajtur “dyer rrotulluese.”
- 73.** Autoritetet rregullatore zyrtare duhet t’u kërkojnë platformave digjitale të raportojnë periodikisht mbi zbatimin e normativave të tyre të shërbimit dhe të marrin masa shtrënguese ndaj atyre platformave digjitale, të cilat shihen se nuk përputhen me vetë politikat e tyre ose që nuk arrijnë të përmbushin përgjegjësinë për të ruajtur lirinë e shprehjes dhe mundësinë e përdorimit të informacionit, si dhe diversitetin e përmbajtjes kulturore. Ato duhet të jenë në gjendje të ndërtojnë një procedurë ankimi dhe të publikojnë rekomandimet e publikut, që mund të jenë detyruese ose jo detyruese, si dhe të hartojnë direktiva transparente dhe të përshtatshme për platformën, për të inkurajuar dhe respektuar të drejtat e njeriut, bazuar në standardet ndërkombëtare të këtyre të drejtave.



- 74.** Edukimi mediatik dhe informativ mbulon një gamë të gjerë kompetencash, të cilat u mundësojnë përdoruesve të mendojnë në mënyrë kritike mbi informacionin me të cilin vihen në lidhje në rrjet. Edukimi mediatik dhe informativ duhet të drejtohet specifikisht përmes sistemit administrativ, për të garantuar efektshmërinë e të gjitha palëve të interesuara, përfshirë dhe platformat digjitale në rolin që kanë marrë përsipër.
- 75.** Edukimi mediatik dhe informativ është më i frytshëm, kur palët e interesuara brenda sistemit administrativ kanë vizion të përbashkët dhe bashkëpunojnë për ta realizuar përmes shkëmbimit të njohurive dhe burimeve. Programet e edukimit mediatik dhe informativ duhet t'i përgjigjen gatishmërisë së teknologjive informative të mediave ekzistuese dhe të atyre të sapo krijuara, në mënyrë që qytetarët të përfitojnë plotësisht nga përdorimi i tyre, për të qenë pjesëmarrës aktivë në shoqëri.
- 76.** Programet edukative mediatike dhe informuese duhet ta vënë theksin te ndërgjegjësimi i përdoruesve dhe të garantojnë se ata i kanë aftësitë dhe njohuritë për të ndërvepruar në mënyrë kritike dhe të efektshme me përmbajtjet, në të gjitha format e mediave të ndryshme dhe me të gjithë ofruesit e informacionit, përfshirë shkollat, universitetet, institucionet kërkimore, bibliotekat, arkivat, muzetë, kompanitë mediatike, botuesit, entet statistikore e të tjerë. Kur programet edukative mediatike dhe informuese theksojnë vetëm aftësitë mbrojtëse ose vetëm sigurinë digjitale, mund të priren më pas për kufizime të tepruara, të detyrueshme në përdorimin e platformave digjitale. Megjithatë, ato duhet t'i japin përparësi hapave specifike, që mund të ndërmarrin përdoruesit, bazuar mbi praktikën më të mira, të botuara nga UNESCO-ja dhe nga organizma të tjerë ndërkombëtarë, për të identifikuar përmbajtjet që duhen kufizuar sipas standardeve dhe legjislacionit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.
- 77.** Programet edukative mediatike dhe informuese duhet të nxisin diversitetin kulturor, përfshirjen sociale dhe qytetarinë globale, me qëllim zvogëlimin e "hendekut të pjesëmarrjes" midis njerëzve të përfshirë në krijimin dhe përdorimin krijues dhe kritik të mediave, të përmbajtjeve informuese dhe të atyre që nuk janë të tilla. Gjithashtu, programet edukative mediatike dhe informuese duhet të mbështesin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si dhe të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e grupeve të cenueshme e të marginalizuara.
- 78.** Qeveritë duhet gjithnjë të marrin parasysh mbështetjen ndaj edukimit mediatik dhe informues, përfshirë aftësimin për sigurinë në rrjet për përdoruesit, veçanërisht të të gjithë grupeve të cenueshme e të marginalizuara, si edhe të grave dhe vajzave. Kështu,

31. Shih "Arsimimi në media dhe informacion: Udhëzimet e politikave dhe strategjive". <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000225606>.



përdoruesit do të përfshihen në mënyrë kritike me përmbajtjet dhe teknologjitë, do të lundrojnë me shpejtësi në një mjedis mediatik dhe informues në zhvillim e sipër, shënjuar nga transformimi digjital, për të promovuar të drejtat e njeriut dhe për të përfunduar aftësitë ripërtëritëse përballë sfidave që lidhen me to.

- 79.** Qeveritë duhet të përhapin informacionin dhe të zhvillojnë aktivitete fushatash sensibilizuese mbi të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital, përfshirë të drejtën e tyre për liri të shprehjes, duke u përqendruar në veçanti në ato çështje që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë mbi fëmijët. Duhet të mbështesin programe edukative për fëmijët, prindërit dhe operatorët socialë, publikun në përgjithësi, si edhe politikëbërësit, për të përmirësuar njohuritë e tyre rreth të drejtave të fëmijëve për mundësitë dhe risqet që lidhen me produktet dhe shërbimet digjitale. Të tilla programe duhet të përmbajnë informacionin se si fëmijët mund të përfitojnë prej produkteve digjitale dhe të zhvillojnë edukimin e tyre mediatik e informativ, përfshirë dhe aftësimin digjital.
- 80.** Platformat duhet të përpilojnë një strategji të qartë dhe publike për të aftësuar përdoruesit dhe për të krijuar një mjedis të favorshëm në rrjet, i cili të mbrojë lirinë e shprehjes dhe mundësisë së përdorimit të informacionit përmes edukimit mediatik dhe informativ, përfshirë edukimin e sigurisë në rrjet. Duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë brenda platformës digjitale për përmirësimin e edukimit digjital të të gjithë përdoruesve, veçanërisht të grupeve të cenueshme e të margjinalizuara.
- 81.** Platformat digjitale duhet të shpërndajnë burime të mjaftueshme për të mbështetur edukimin mediatik dhe informativ të të gjithë përdoruesve, përfshirë edukimin digjital mbi produktet dhe shërbimet e vetë platformës, si edhe të procedurave që lidhen me të. Përdoruesit duhet të ndihmohen të kuptojnë sa më mirë mënyrat me të cilat një platformë e caktuar paraqet, mirëmban, rekomandon dhe/ose sinjalizon një ose më shumë përmbajtje (gjithashtu të lidhura me fazat e renditura në Parimet 3 dhe 4 më poshtë), por edhe për hapa të veçantë që përdoruesit mund të ndërmarrin vetë, për të identifikuar përmbajtje që duhen kufizuar, sipas legjisllacionit dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
- 82.** Platformat duhet të trajnojnë ekipet e tyre të zhvillimit të produkteve mbi edukimin mediatik dhe informues, përfshirë sigurinë në rrjet, nga perspektiva e aftësimin të përdoruesit dhe bazuar në standardet ndërkombëtare si edhe të zbatojnë mekanizma monitorues dhe vlerësues të brendshëm dhe të pavarur.
- 83.** Qeveritë dhe platformat digjitale duhet të zbatojnë programe të edukimit mediatik dhe informues në bashkëpunim të ngushtë me organizata dhe ekspertë të ndryshëm të pavarur të platformave, duke përfshirë, por jo vetëm, edhe: autoritetet publike përgjegjëse për edukimin mediatik dhe informues, botën akademike, organizatat e shoqërisë civile që punojnë me grupe të cenueshme ose të margjinalizuara, punonjës

shkencorë, bibliotekarë, mësues, edukatorë të fushës, gazetarë, artistë dhe profesionistë të botës së kulturës. Duhet marrë masa të veçanta për përdoruesit dhe jo-përdoruesit dhe për audiencat e grupeve të cenueshme e të marginalizuara, siç theksohet në shumë instrumente të UNESCO-s, të disponueshme për edukimin mediatik dhe informues.

84. Qeveritë dhe platformat digjitale duhet të bashkëpunojnë dhe të garantojnë që përdoruesit t'i kuptojnë të drejtat e tyre në rrjet dhe jashtë rrjetit, përfshirë rolin e medias dhe edukimit informues në ushtrimin dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të mundësisë së përdorimit të informacionit.



## Parimi 1. Platformat tregojnë kujdesin e duhur për të drejtat e njeriut.

### *Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe vlerësimi i riskut*

- 85.** Në çfarëdo marrëveshje rregullatore, platformat digjitale duhet të arrijnë të vënë në dukje sistemet ose procedurat që kanë vendosur për të garantuar të drejtat e njeriut, falë kujdesit dhe këmbënguljes të pandërprerë, përfshirë të drejtat e njeriut dhe vlerësimin e ndikimit të barazisë gjinore,<sup>32</sup> si edhe masat e zvogëlimit të riskut.<sup>33</sup> Këto sisteme duhet të rishikohen periodikisht dhe ky rishikim duhet të bëhet publik.
- 86.** Në harmoni me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Parimet Udhëheqëse të OKB-së mbi Sipërmarrjen dhe Të Drejtat e Njeriut, platformat duhet të kryejnë periodikisht vlerësime të riskut, për të identifikuar dhe trajtuar çdo ndikim real

32. Shih “Deklaratën e 18 Tetorit 2021 nga Irene Khan, Raportuesja Speciale për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes.” Në përputhje me Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, “kompanitë e mediave sociale duhet të kryejnë rregullisht vlerësime të ndikimit në të drejtat e njeriut dhe gjinisë për të identifikuar dhe zbutur rreziqet sistematike që prekin gratë dhe personat që nuk përputhen me gjininë. Ato duhet të bëjnë platformat të sigurta dhe përfshirëse për gjininë, dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të adoptojnë politika dhe mjete efektive sigurie, të sigurojnë transparencë kuptimplotë, përfshirë algoritmet, dhe të ofrojnë mjete të përshtatshme korrigjuese.” <https://www.ohchr.org/en/statements/2022/02/state-ment-irene-khan-special-rapporteur-promotion-and-protection-freedom-opinion>.

33. Vlerësimet e ndikimit në të drejtat e njeriut duhet të përfshijnë të gjitha të drejtat e njeriut që politikat e kompanive mund të ndikojnë. Kjo përfshin të drejtat civile dhe politike si liria e shprehjes, qasja në informacion dhe privatësia, si dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të drejtën për të qenë i lirë nga dhuna dhe të drejtën për të marrë pjesë në jetën publike, ndër të tjera.



ose potencial të veprimtarive të tyre mbi të drejtat e njeriut. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut të të drejtave të njeriut, platformat digjitale duhet të marrin parasysh se si ndikon çdo produkt ose shërbim të sjellja e përdoruesit, përtej qëllimit të përfshirjes dhe përvetësimit të aftësive nga ana e përdoruesit.

- 87.** Vlerësimet e riskut duhet të përbëjnë një pikë vendimtare në procesin e vendimmarrjes të platformave digjitale, duke e bërë të ditur qasjen e programimit dhe të funksionimit të shërbimeve të tyre si edhe të masave zbutëse që zbatohen ndaj rreziqeve të mundshme, për të mbrojtur të drejtat e njeriut, mos-diskriminimin dhe trajtimin e barabartë. Gjithashtu, përgjegjësitë për menaxhimin e riskut duhet të specifikohen qartë dhe të zbatohen në nivelet më të larta, ndërsa veprimtaritë për menaxhimin e riskut duhen raportuar rregullisht në organet më të larta vendimmarrëse.
- 88.** Së paku, të drejtat e njeriut dhe vlerësimet e riskut duhet të kryhen:
- a.** Përpara çdo modifikimi të rëndësishëm, çdo vendimi të rëndësishëm politik (përfshirë edhe ato që lidhen me sistemin e publicitetit, nëse e kërkon rrethana), ndryshime në operacione, aktivitete apo marrëdhënie/partneritete të reja.
  - b.** Rregullisht, për të mbrojtur të drejtat e të gjitha grupeve të cënueshme apo të marginalizuara, si edhe të grave dhe vajzave, gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe të mjedisit.<sup>34</sup>
  - c.** Përpara fushatave elektorale, për të mbrojtur integritetin e tyre.<sup>35</sup>
  - d.** Në rast urgjencash, krizash, konflikti apo ndryshimesh të rëndësishme në mjedisin operativ.<sup>36</sup>
- 89.** Gjatë procesit të verifikimit, platformat duhet të garantojnë përfshirjen e rëndësishme dhe të shumëllojshme të palëve të interesuara për të identifikuar risqet e veçanta për grupet e cënueshme apo të marginalizuara. Është themelore që platformat digjitale të jenë të hapura ndaj ekspertëve dhe opinionëve të pavarura për mënyrën e organizimit të vlerësimeve.
- 90.** Që në fillim, platformat duhet të krijojnë hapësira për të dëgjuar dhe për të përfshirë përdoruesit, edhe ata që kanë përjetuar ngacmime ose abuzime, përfaqësuesit e tyre dhe përdoruesit nga grupet e cënueshme ose të marginalizuara, si gratë dhe vajzat, gazetarët, artistët, për t'i informuar për procedurat dhe politikat e platformës. Këtu mund të përfshihen dhe metoda për të identifikuar dhe për të kundërshtuar përmbajtjet që legjislati ndërkombëtar dhe standardet e të drejtave të njeriut autorizojnë të kufizohen, si edhe mundësitë dhe zgjidhjet për të shmangur risqet e vlerësuara.

34. Shiko Dispozita të veçanta lidhur me kontekstin, paragrafi 126.

35. Shiko Dispozita të veçanta lidhur me kontekstin, paragrafi 127-37.

36. Shiko Dispozitat të veçanta lidhur me kontekstin, paragrafi 138-40.



## Parimi 2. Platformat përputhen me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë në objektivat e tyre shqyrtimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes.

91. Platformat digjitale duhet të garantojnë që kujdesi për të drejtat e njeriut dhe procedurat e rregullta të jenë të integruara në të gjitha etapat e procesit të konceptimit, si edhe në shqyrtimin e përmbajtjes, të politikave dhe praktikave mbrojtëse.

### *Procedurat e projektimit*

92. Përcaktimi i produkteve të reja, shqyrtimi i përmbajtjes dhe politikave mbrojtëse të platformave digjitale, duhet të jetë në harmoni me përgjegjësinë e sipërmarrjeve për të respektuar të drejtat e njeriut, si theksohet në Parimet Udhëheqëse të OKB-së mbi Sipërmarrjen dhe të Drejtat e Njeriut dhe në standarde të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
93. Platformat digjitale duhet të garantojnë mos-diskriminimin dhe trajtimin e barabartë në procedurat e tyre projektuese, si edhe politikave të tyre të shqyrtimit të përmbajtjes dhe të politikave, praktikave e sistemeve mbrojtëse. Gjithashtu, përballjen e paragjytimeve, stereotipeve dhe algoritmeve diskriminues ose

praktika kontrolli të përmbajtjeve që ndikojnë mbi gratë dhe vajzat, si edhe mbi grupet cenueshme ose të marginalizuara, përfshirë komunitetet indigjene. Duhet të ekzistojë pritshmëria se platformat digjitale i garantojnë të gjithë përdoruesve, pavarësisht nga background-i apo aftësitë e tyre, se u sigurohet pjesëmarrje e plotë në këto shërbime.

## ***Kontrolli i përmbajtjes dhe politikat e praktikave të shpërndarjes së përmbajtjes***

- 94.** Kontrolli i përmbajtjes dhe sistemet shpërndarëse, përfshirë elementët e automatizuar e jo të automatizuar, duhet të jenë të besueshëm dhe të efektshëm dhe t'i përshtaten nivelit të volumit të përmbajtjeve të kontrolluara, në të gjitha juridiksionet ku vepron platforma. Këtu përfshihet zbatimi i përpikërisë dhe mos-diskriminimit në metodat e shqyrtimit. Kontrolli i përmbajtjes dhe shpërndarja e saj duhet të zbatohen në harmoni me legjislacionin e standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht për të mos lejuar pengimin e lirisë së shprehjes dhe të diversitetit kulturor.
- 95.** Vendimet e kontrollit të përmbajtjes në të gjitha rajonet dhe në të gjitha gjuhët, në mënyrë transparente duhet të marrin parasysh kontekstin, shumëllojshmërinë e nuancave gjuhësore dhe veçantitë kulturore, që ndikojnë në kuptimin dhe veçoritë gjuhësore e kulturore të përmbajtjes.
- 96.** Platformat që operojnë në mjedise shumëgjuhëshe duhet të garantojnë se kontrolli i automatizuar i përmbajtjes është i disponueshëm në të gjitha gjuhët kryesore që fliten në atë mjedis (së paku) dhe në nivel të përshtatshëm me volumin e përmbajtjes.
- 97.** Platformat digjitale duhet të garantojnë veprim të shpejtë dhe vendimtar për të hequr materiale abuzive të njohura ose akte terrori live streaming ndaj fëmijëve, për të respektuar të drejtat e çdo individi, përfshirë grupet e cenueshme ose të marginalizuara. Nga ana tjetër, platformat duhet të sigurohen që një përmbajtje e tillë, e cila mund të ketë rëndësi të madhe në hetimin dhe ndjekjen e krimit, të mos hiqet, por më saktë të ruhet dhe të jetë e sigurt, për t'u përdorur nga agjencitë e mbrojtjes së ligjit dhe të hetuesve, sipas rasteve.
- 98.** Sa më sipër, i takon shtetit të mbajë përgjegjësinë për të garantuar të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të sigurojë se çdo kufizim përmbajtjeje është në zbatim të standardeve dhe të legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, veçanërisht të neneve 19 (3) dhe 20 të ICPPR-së. Megjithatë, platformat digjitale duhet të jenë në gjendje të tregojnë se çdo veprim i ndërmarrë, kur kontrollojnë dhe shpërndajnë përmbajtjet kryhet sipas normave të shërbimeve dhe të standardeve komunitare dhe duhet të raportojnë me përpikëri në sistemin e administrimit ose në sistemin gjyqësor të pavarur mbi veprimtarinë që kryejnë, në respektim të përgjegjësisë dhe planeve të tyre.

- 99.** Kur marrin në shqyrtim masa për të kufizuar përmbajtjet, platformat duhet të kenë parasysh kushtet lidhur me kufizimet legjitime për lirinë e shprehjes sipas nenit 19, paragrafi 3, të ICCPR-së dhe për ndalimin e urrejtjes që nxit diskriminim, armiqësi ose dhunë, sipas nenit 20, paragrafi 2 i ICCPR-së, përfshirë testin bazë me gjashtë pika, për të përcaktuar këtë përmbajtje të formuluar në Planin e Veprimit të Rabatit.
- 100.** Pasi platformat digjitale identifikojnë përmbajtjen, që autorizohet të kufizohet në bazë të standardeve dhe të legjislacionit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, duhet të ndërmarrin masa të tilla si: të ofrojnë alternativa informacioni të besueshme; duke u vënë në dukje përdoruesve shqetësimet rreth origjinës së përmbajtjes; të kufizojnë ose të shmangin përhapjen e algoritmit të kësaj përmbajtjeje, t'i kushtojnë vëmendjen e duhur përmbajtjeve që pasqyrojnë paragjykime gjinore ose dhunë me bazë gjinore; të shmangin përmbajtjet me vlera monetare nga të ardhurat e publicitetit; duke e hequr ose zhvendosur atë përmbajtje.<sup>37</sup>

## ***Kontrolli njerëzor i përmbajtjes***

- 101.** Moderatorët njerëzorë të përmbajtjes, ata që janë të punësuar drejtpërdrejt nga platformat ose ata që janë kontraktorë të jashtëm me rol të jashtëm, duhet të trajtohen me shumë kujdes, të flasin rrjedhshëm gjuhën e platformës dhe të njohin kontekstet lokale gjuhësore e kulturore, të jenë të verifikuar, të vlerësuar e të mbështetur psikologjikisht. Platformat më tej duhet të prodhojnë programe të mbështetura mirë financiarisht e me stafe të plotë për moderatorët e përmbajtjes, për të zvogëluar dëmin që atyre u shkaktohet gjatë punës nga përballja dhe ekspozimi me përmbajtje të dhunshme ose shqetësuese. Numri i moderatorëve njerëzorë duhet të përkojë me kompleksitetin e volumit të përmbajtjes, me të cilën ata do të merren.
- 102.** Platformat duhet edhe të shpjegojnë qartë nëse bashkëpunojnë me palë të treta që ofrojnë shërbim moderimi të përmbajtjes, organizata të jashtme apo ekspertë, për t'i ndihmuar ata të marrin vendime, sidomos në vende ose rajone ku vetë platformat kanë pak njohje lokale. Në këtë mënyrë, platformat gjithnjë duhet të jenë të kontrolluara dhe të përmbajtura në shpalljen e partnerëve të tyre, që mund të vihen në rrezik jete.

---

37. Masat e aplikuara duhet të jenë gjithmonë proporcionale me objektivin legjitim që ato synojnë të mbrojnë. Heqja dhe bllokimi i përmbajtjes dhe pezullimi ose bllokimi i llogarive duhet të jenë mjetet e fundit të mundshme dhe duhet të përdoren vetëm në rastet më të jashtëzakonshme.

## ***Përdorimi i sistemeve të automatizuara për kontrollin dhe shpërndarjen e përmbajtjes***

- 103.** Aty ku nevojitet, platforma digjitale duhet të ushtrojë audite të rregullta të jashtme, me hapa pasuese detyruese, për mjetet e automatizuara dhe njerëzore, që përdoren për kontrollin e përmbajtjes, shpërndarjen e saj dhe për të rekomanduar mekanizma për saktësinë, kujdesin e tyre dhe për paragjykime të mundshme diskriminuese, që depërtojnë përmes lloje të ndryshme përmbajtjeje, gjuhe dhe konteksti; gjithashtu duhet të kontrollojë aftësinë e tyre gjuhësore dhe përdorimin koherent në të gjitha juridiksionet. Si theksohet në paragrafin 87, ato duhet gjithashtu të ushtrojnë vlerësim të rregullt e të pavarur mbi ndikimin e sistemeve të tyre publicitare mbi të drejtat e njeriut, diversitetin kulturor dhe barazinë gjinore. Rezultatet e këtyre verifikimeve duhet të bëhen publike.<sup>38</sup>
- 104.** Platformat digjitale duhet të ndërtojnë sisteme dhe procedura për të identifikuar dhe për të ndërmarrë aksionet e nevojshme, sipas dispozitave të këtyre Udhëzimeve, përderisa çdo aspekt i projektimit të shërbimeve të platformave mund të shpjerë në zgjerimin e përmbajtjes, që mund të kufizohet sipas standardeve dhe legjislacionit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.
- 105.** Gjithashtu platformat duhet të garantojnë që sistemet e mbrojtjes dhe të rekomandimeve, përfshirë mjetet njerëzore dhe ato të automatizuara, të mos përhapin përmbajtje që mund të kufizohen sipas standardeve dhe legjislacionit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.
- 106.** Platformat gjithashtu duhet të garantojnë se përmbajtjet që mund të jenë subjekt për kufizim, sipas standardeve dhe legjislacionit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut të mos përhapen nga shpërndarja e automatizuar ose nga mekanizma rekomandues, thjesht për arsye të kufizimeve gjuhësore të këtyre mekanizmave.
- 107.** Platformat digjitale duhet të jenë në gjendje t'i shpjegojnë sistemit administrues përdorimin dhe ndikimin e sistemeve të automatizuara, si edhe shtrirjen deri ku këto mjete ndikojnë në mbledhjen e të dhënave, në publicitetin e synuar dhe në përhapjen, kategorizimin dhe/ose heqjen e përmbajtjes, përfshirë përmbajtjet artistike ose ato të lidhura me zgjedhjet.
- 108.** Platformat digjitale duhet t'i ofrojnë përdoruesve opsione për të përshtatur shpërndarjen e përmbajtjes me sistemet e kontrollit. Përdoruesve u duhet dhënë aftësia të kontrollojnë përmbajtjen që shohin dhe të munden lehtësisht të kuptojnë se mund të kenë mundësi përdorimi të burimeve të ndryshme dhe këndvështrimesh

38. Një opsion është që auditet dhe vlerësimet e pavarura të bëhen në përputhje me standardet globale dhe idealisht të verifikohen nga një trup i pavarur në mënyrë që të mund të përdorin të njëjtat raporte pavarësisht mënyrës si funksionon rregullatori.




mbi çështje aktuale. Gjithashtu, platformave u duhet kërkuar t'u japin përdoruesve opsione për të menaxhuar mbledhjen e të dhënave personale dhe mundësi shqyrtimi të përgjigjeve të këshilluesve të përmbajtjeve të preferuara ose të hamendësuar.

**109.** Platformat digjitale nuk duhet të përdorin të dhëna personale që përftohen drejtpërdrejt nga fëmijët, që përftohen jo-drejtpërdrejt apo që hamendësohen për fëmijët, përmes burimeve të tjera me qëllim mbledhjen e të dhënave.

## **Shënim**

**110.** Platformat digjitale duhet t'i informojnë përdoruesit, kur përmbajtja e tyre hiqet, si edhe arsyen e kësaj heqjeje. Në këtë mënyrë përdoruesit do të kuptojnë përse u ndërмор ky veprim, metodën e përdorur (përmes mjeteve të automatizuara apo ndërhyrjes njerëzore) dhe në cilën platformë u ndërмор ky veprim. Platformat digjitale duhet të kenë procedura që u mundësojnë përdoruesve të përdorin këto vendime. (shih paragrafët 125-28). Kjo dispozitë mund të ndryshojë në varësi të madhësisë së ndërmarrjes dhe se deri në çfarë mase ekzistojnë procedura për përdoruesit, që ata ta kundërshtojnë këtë veprim.



## Parimi 3. Platformat janë transparente

- 111.** Platformat digjitale duhet të informojnë rregullisht publikun dhe sistemin administrues se si përputhen me parimet e transparencës dhe të shpjegueshmërisë dhe si e pasqyrojnë këtë sipas normativave të shërbimit dhe të standardeve të komunitetit. Këtu përfshihen përgjigjet e tyre ndaj kërkesave të administrimit për heqjen e informacionit ose të përmbajtjes.<sup>39</sup> Zbatimi i kësaj dispozite mund të ndryshojë sipas praktikës bazuar në përmasat e kompanisë, për të zvogëluar barrën e kompanive më të vogla dhe të start-up-eve.
- 112.** Transparenca duhet të jetë e rëndësishme: informacioni i dhënë duhet të jetë mundësisht sa më i qartë dhe i përmbledhur; dhe kompleks aq sa është e nevojshme. Transparenca nuk është thjesht dhënia e teksteve juridike ose shkarkimi i të dhënave, por një informacion, i cili u nevojitet partnerëve për të marrë vendime bazuar në të dhëna të sakta.
- 113.** Standardet e transparencës të paraqitura në këto Udhëzime mund të konsiderohen si minimumi për t'u plotësuar nga të gjitha kompanitë në kuadër të objektivit të çdo sistemi administrues.

### *Transparenca domethënëse*

- 114.** Efektshmëria e mekanizmave të transparencës të platformave digjitale duhet të matet

39. Udhëzime për transparencën në platformat digjitale mund të gjenden në 26 parimet e nivelit të lartë të vendosur nga UNESCO në *Lër Diellin të Shkëlqejë: Transparenca dhe Përgjegjshmëria në Epokën Digjitale* <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000377231>.

në mënyrë të pavarur, në raport me standardet ndërkombëtare përmes vlerësimeve sasiore dhe cilësore, për të përcaktuar nëse informacioni i ofruar për një transparencë kuptimplote e ka arritur qëllimin. Raportet duhet të bëhen rregullisht publike.

**115.** Platformat digjitale duhet të publikojnë informacione, ku të shpjegojnë mënyrën se si garantojnë se konsideratat lidhur me të drejtat e njeriut dhe procedurat e rregullta janë të integruara në të gjitha fazat e kontrollit të përmbajtjes dhe të politikave e të praktikave shpërndarëse. Ky informacion i disponueshëm duhet të përmbajë:

## Transparenca lidhur me normativat e shërbimit të platformës digjitale

- a. Të gjitha masat e marra për të kontrolluar dhe përzgjedhur përmbajtjen, të vendosura nga normativat e shërbimit të platformës, përfshirë, për shembull, listën e përmbajtjeve të ndaluara ose të përdoruesve të ndaluar.
- b. Çdo informacion mbi procedurat e përdorura për të respektuar normat e tyre të shërbimit dhe për të sanksionuar përdoruesit, si edhe pyetjet/kërkesat e organeve administruese për heqjen e përmbajtjeve, kufizimin ose promovimin e përmbajtjeve.
- c. Informacionet mbi arsyet e kufizimeve të vendosura në lidhje me përdorimin e normave të tyre të shërbimit duhet të jenë të disponueshme për publikun në format lehtësisht të arritshëm sipas normave të shërbimit.
- d. Informacion rreth atyre përmbajtjeve që konsiderohen të ndaluara ose në kundërshtim me normativat dhe masat e shërbimit të platformës digjitale, përfshirë rrethanat në të cilat platforma digjitale pezullon një llogari përdoruesi, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme.

## Transparenca lidhur me zbatimin e kontrollit të përmbajtjes dhe të politikave dhe praktikave shpërndarëse

- e. Si kontrollohet dhe shpërndahet përmbajtja, përmes mjeteve të automatizuara dhe verifikimit njerëzor, po ashtu dhe përmbajtjet që hiqen ose ndalohen sipas normativave të tjera të shërbimit ose sipas pyetjeve/kërkesave të sistemeve administruese. Ky proces duhet të përfshijë informacion sasior dhe cilësor mbi rezultatet e arritura dhe mbi ndikimin që ushtrojnë këto sisteme.
- f. Çdo ndryshim në kontrollin e përmbajtjes duhet t'u njoftohet përdoruesve periodikisht në formatet e arritshme prej tyre.

- g.** Çdo përdorim i kryer nga mjetet e automatizuara me qëllim kontrollin dhe shpërndarjen e përmbajtjes, përfshirë sqarimin se çfarë roli kanë këto mjete në procesin e rishqyrtimit, si edhe indikatorët e mundshëm të përfitimeve dhe kufizimeve prej mjeteve të automatizuara për përmbushjen e këtyre qëllimeve.
- h.** Të gjitha garancitë e zbatuara për kontrollin dhe përzgjedhjen e përmbajtjes, të caktuara në mbrojtje të lirisë së shprehjes, mundësitë e përdorimit të informacionit dhe të përmbajtjeve të ndryshme kulturore, edhe përgjigjet e kërkesave të organeve drejtuese, veçanërisht ato që lidhen me interesat e publikut, por edhe me përmbajtjet gazetareske, artistike e kulturore si edhe të drejtat e pronësisë intelektuale.
- i.** Informacion mbi numrin e moderatorëve njerëzorë të punësuar ose të nën/kontraktuar dhe mbi natyrën e eksperiencës së tyre në gjuhën(t) dhe kontekstin lokal si edhe nëse ata janë staf personel i brendshëm apo të nën-kontraktuar.
- j.** Si janë mbledhur të dhënat personale, si janë përdorur, përhapur, arkivuar dhe bashkëndarë dhe si janë trajtuar të dhënat personale; cilat të dhëna personale e me ndjeshmëri të lartë janë përdorur për të marrë vendime algoritmike me qëllim kontrollin dhe përzgjedhjen e përmbajtjes. Këtu përfshihet edhe mënyra se si bashkëndahen të dhënat personale me entitete të tjera dhe cilat të dhëna personale platforma i përfiton jo-drejtëpërdrejt, për shembull, përmes profilit të përdoruesit ose përmes ndërveprimit me pjesë të tjera të ekosistemit digjital.

## Transparenca lidhur me ankesat e përdoruesve

- k.** Informacion lidhur me ankesat për heqje, bllokim ose refuzim për bllokim të përmbajtjes dhe se si përdoruesit mund të hyjnë në procesin e ankimimit. Ky informacion duhet të jetë sasior dhe cilësor mbi marrjen e ankesave, mbi trajtimin, pranimin ose refuzimin e tyre, mbi rezultatet e këtyre ankesave, mbi ankesat e ardhura nga punonjës të shtetit si edhe mbi veprimet e ndërmarra.

## Transparenca mbi praktikat publicitare të platformave digjitale

- l.** Për platformat digjitale që e përdorin publicitetin si pjesë të modelit të tyre të sipërmarrjes, informacioni mbi njoftimet politike dhe ato me interes publik, përfshirë autorin dhe ata që paguajnë për këto njoftime, duhet të ruhen në një bibliotekë online të arritshme nga publiku.
- m.** Praktikrat e publicitetit dhe mbledhja e të dhënave e të rezultateve të të drejtave të njeriut dhe të vlerësimit të ndikimit me bazë gjinore të sistemeve publicitare.

**n. Informacion, i cili u mundëson individëve të kuptojnë bazën mbi të cilën u transmetohet një publicitet i caktuar.**

**o. Përmbajtjet që burojnë vetëm nga makineritë duhet të etiketohen si të tilla.**

## ***Përdorimi i të dhënave për qëllime kërkimore***

**116.** Platformat digjitale duhet t'u ofrojnë kërkuesve të verifikuar mundësi për përdorimin e të dhënave jo-personale dhe të të dhënave me pseudonim, si proces i nevojshëm për të kuptuar ndikimin e platformave digjitale. Këto të dhëna duhet të jepen në bazë të kërkesës dhe mbi një bazë të vazhdueshme përmes mjeteve të automatizuara, si programacioni i aplikacioneve *interface* (API), ose përmes zgjidhjeve të tjera teknike të hapura e të mundësueshme, që lejojnë analizën e të dhënave të sipërpërmendura.

**117.** Platformat digjitale duhet t'u ofrojnë mundësi përdorimi të të dhënave jo-personale gazetarëve dhe grupeve të avokatisë, kur është fjala për interesin e publikut dhe kur ky mundësim është i proporcionuar dhe i nevojshëm për një kontekst të caktuar. Gjithashtu janë të nevojshme masa të tjera mbrojtëse për privatësinë e përdoruesve dhe të të dhënave personale, si garancia e anonimitit të grupit të të dhënave përmes masave të ndryshme, përfshirë de-identifikimin dhe grupimin përpara bashkëndarjes, si edhe informacion për pronësinë e sipërmarrjes, sekretin tregtar dhe respektimin e konfidencialitetit të tregut.

**118.** Platformat duhet të krijojnë *interface* të besueshme për mundësimin e përdorimit të të dhënave, të ofrojnë të dhëna të shkëputura, bazuar në barazinë gjinore dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm e të penguar (si raca, etnia, mosha, gjendja socio-ekonomike, aftësia e kufizuar, etj.). Sistemet administrative duhet të përcaktojnë çfarë është e dobishme, e proporcionuar dhe e arsyeshme për qëllime kërkimore.



## Parimi 4. Platformat ofrojnë informacion dhe mjete të disponueshme për përdoruesit


### *Gjuha dhe mundësia e përdorimit*

- 119.** Platformat duhet t'i kenë të disponueshme normativat e tyre të plota të shërbimit në gjuhët kryesore zyrtare të çdo vendi ku ato veprojnë, të garantojnë se janë në gjendje t'u përgjigjen përdoruesve në gjuhën e tyre, të shqyrtojnë menjëherë ankesat e tyre dhe të jenë të gatshme të kontrollojnë e të shpërndajnë përmbajtjen në gjuhën e përdoruesit. Mund të përdoren përkthyesit e automatizuar të gjuhës, për të ofruar mundësi më të mëdha përdorimi të saj, por saktësia e tyre duhet kontrolluar, për shkak të kufizimeve teknike që kanë.
- 120.** Platformat digjitale duhet të garantojnë se raportet, njoftimet dhe ankesat janë të disponueshme në gjuhën në të cilën përdoruesit ndërveprojnë me shërbimin.
- 121.** Atje ku platformat digjitale janë të arritshme nga fëmijët, ato duhet t'u ofrojnë të gjithë fëmijëve mundësi të barabartë dhe të frytshme të informacionit dhe të garantojnë mbrojtjen e lirisë së tyre të shprehjes e të privatësisë.<sup>40</sup> Normat e shërbimit dhe standardet e komunikimit duhet të jenë të disponueshme e të përkohjshme me

40. OHCHR. 2021. "Koment i Përgjithshëm Nr. 25 (2021) për sa i përket të drejtave të fëmijëve në lidhje me mjedisin digjital." <https://www.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/general-comment-no-25-2021-childrens-rights-relation>.

gjuhën e moshës për fëmijët dhe, nëse është e përshtatshme, të krijohen në bazë të pikëpamjes së grupeve të ndryshme të fëmijëve; vëmendje e veçantë i duhet kushtuar nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, për të garantuar që ata të arrijnë nivele të barabarta në mundësitë e përdorimit të informacionit, siç është parashikuar në seksionin e mëparshëm.

**122.** E drejta e personave me aftësi të kufizuar duhet të merret gjithnjë parasysh, me vëmendje të veçantë për mënyrat me të cilat ata ndërveprojnë dhe për të shprehur ankesat në lidhje me platformën. Platformat duhet të zbatojnë korrigjimet e nevojshme për ta bërë të arritshëm informacionin lidhur me normativat e tyre të shërbimit, raportet, njoftimet dhe ankesat.



## Parimi 5. Platformat janë përgjegjëse ndaj palëve kryesore

### *Raportimi i përdoruesit*

- 123.** Platformat duhet të vendosin mekanizma raportues për përdoruesit dhe jo-përdoruesit ose për palët e treta, që përfaqësojnë interesat e tyre, në mënyrë që ato të mundën të raportojnë cenime të mundshme të politikave. Duhet përfshirë mekanizma ankimimi të efektshëm dhe të arritshëm për anëtarët e grupeve të cenueshme ose të marginalizuara. Platformat digjitale gjithashtu duhet të kenë mjete për të kuptuar kushtet kontekstuale lokale, kur u përgjigjen ankesave të përdoruesve, duke garantuar një sistem projektues të ndjeshëm kulturor. Për fëmijët duhet të krijohen mekanizma të veçanta raportuese, të ndërtuara për përdorim të shpejtë e të lehtë.
- 124.** Sistemi raportues i përdoruesit duhet të ketë si përparësi shqetësimet lidhur me përmbajtjet që kërcënojnë përdoruesit, të garantojë përgjigje të menjëhershme, të krijojë një kanal përgjigjeje të veçantë në disa nivele dhe mjete të arkivimit të raportimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për dhunim të të drejtave të njeriut, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe ngacmimin.
- 125.** Kompanitë duhet të marrin masa parandaluese ndaj keqpërdorimit të sistemit raportues përmes sjelljeve jo autentike të koordinuara.



## **Përgjigja ndaj ankesës së përdoruesit**

- 126.** Është e nevojshme të ngrihen mekanizma të efektshme në përgjigje të ankesave të përdoruesve të jashtëm mbi platformën, për t'i mundësuar përdoruesve (dhe jo-përdoruesve, nëse janë ndikuar nga përmbajtje të veçanta) të shprehin shqetësimet e tyre dhe t'u garantohet një shpërblim i përshtatshëm. Ky veprim nënkupton hapjen e një kanali raportimi të qartë, lehtësisht të arritshëm, të parapëlqyer, të besueshëm<sup>41</sup> e të kuptueshëm për ankesat në gjuhën e tyre lokale, ku të njoftohen përdoruesit për përgjigjen ndaj këtyre ankesave.
- 127.** Mekanizmi i ankimit duhet të ndjekë shtatë parimet e përvijuara në Parimet Udhëheqëse të OKB-së mbi Sipërmarrjen dhe të Drejtat e Njeriut për mekanizmat e efektshme të ankimit: legjitimiteti, mundësimi, parashikimi, barazia, transparencja, të drejtat, pajtueshmëria dhe nxënja e vazhdueshme.
- 128.** Platformat digjitale duhet të njoftojnë përdoruesit dhe të shpjegojnë procedurat e ankimit, kur, në mënyrë të qartë, u hiqet përmbajtja e tyre, kur u kufizohet për terma komentuese ose në bashkëndarje e në publicitet; kur i nënshtrohen një kufizimi të veçantë në përhapje ose rekomandim (në dallim nga përhapja dhe rekomandimi "organik/algorithmik") dhe përse. Kështu përdoruesit do të mundin të kuptojnë arsyet përse u ndërmor ky veprim në përmbajtjet e tyre, metodën e përdorur (mjetet e automatizuara ose verifikim njerëzor) dhe rregullat e cilës platformë u zbatuan. Gjithashtu, platformat duhet t'u mundësojnë përdoruesve të ankimohen ndaj këtyre vendimeve dhe të kërkojnë shpërblimin e duhur.
- 129.** Kompanitë duhet të punojnë që të garantojnë se sistemet e ankimit dhe të shpërblimit nuk abuzohen nga sjellje jo autentike të koordinuara.

---

41. Garantimi i sigurisë së përdoruesve dhe respektimi i ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.



## Dispozita të veçanta lidhur me kontekstin

***Mbrojtja e të drejtave të të gjithë personave të cënueshëm të marginalizuar, të grave dhe vajzave dhe të profesionistëve, mund të rrezikohet për shkak të ushtrimit të lirisë së tyre të shprehjes dhe disponimit të informacionit, si e gazetarëve, artistëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe të mjedisit.***

**130.** Platformat digjitale duhet të organizojnë mbrojtje të veçantë për gratë dhe vajzat, për përdoruesit e grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara si dhe për gazetarët, artistët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe të mjedisit. Për të arritur këtë, platformat digjitale duhet:

- a.** Të kryejnë rregullisht vlerësime të ndikimit të të drejtave të njeriut dhe të barazisë gjinore mbi sistemet e tyre të kontrollit të politikave dhe të qasjeve algoritmike, për të identifikuar risqet e sistemit për grupet e cënueshme ose të marginalizuara, të grave dhe vajzave, të gazetarëve, artistëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe të mjedisit, si dhe të hartojnë politika dhe praktika për të ulur këto risqe.
- b.** Të përdorin teknologji mbrojtëse të privatësisë për t'u mundësuar studiuesve të jashtëm të dhënat e brendshme, për të identifikuar përhapjen algoritmike online të dhunës me bazë gjinore ose të prirjeve të tjera të dhunës së shkakuar nga teknologjitë në zhvillim e sipër.

- c.** Të krijojnë ekipe inxhinierike të përkushtuara dhe gjithëpërfshirëse, të cilat janë të trajnuara veçanërisht për të zhvilluar zgjidhje algoritmike për kontrollin dhe shpërndarjen e përmbajtjes.
- d.** Të zhvillojnë dhe të mbështesin mekanizma reaguese të komunitetit, gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, për të luftuar kundër paragjykimeve seksiste, kulturore dhe paragjykimeve të tjera në teknologjitë e reja.
- e.** Të vlerësojnë ndikimin e të drejtave të njeriut në sistemet e tyre dhe në procedurat e trajtimit të përmbajtjeve të gazetarëve dhe botuesve të rinj të pavarur, të pranuar në shërbimin e tyre.
- f.** Të garantojnë trajtim të barabartë të organizatave të reja të pavarura në platformat digjitale.
- g.** Të hartojnë procedura mbrojtjeje ndaj çdo përdorimi abuziv të mundshëm të rregullave të raportimit dhe të mekanizmave të kontrollit, veçanërisht të keqpërdorimit dhe të shpërdorimit të besimit, me synim censurimin e grupeve të cenushme dhe të marginalizuara, gratë dhe vajzat, gazetarët, artistët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe të mjedisit.

## **Masa të veçanta për integritetin elektoral<sup>42</sup>**

- 131.** Platformat digjitale duhet të njohin rolin e tyre në mbështetjen e institucioneve demokratike, duke ruajtur integritetin elektoral. Ato duhet të kryejnë një proces specifik të vlerësimit të risqeve për integritetin e fushatës elektorale përpara dhe gjatë ngjarjeve më të mëdha të zgjedhjeve në nivel kombëtar, gjatë zgjedhjeve të rëndësishme rajonale ose gjatë referendumeve kushtetuese (për shembull, për legjislaturën ose kreun e shtetit në një sistem presidencial).
- 132.** Këto vlerësime duhet të jenë transparente, në harmoni me kujdesin për të drejtat e njeriut dhe të realizohen me kontributin e të gjitha palëve të përfshira në zgjedhje. Vlerësimet duhet të kryhen përpara zgjedhjeve me qëllim marrjen e masave konkrete për të zvogëluar risqet e identifikuar. Vlerësimet duhet të përfshijnë qasjen e barazisë gjinore, duke pasur parasysh rritjen e dhunës në rrjet kundër grave votuese, kandidatëve, aktivisteve, përfaqësuesve të zgjedhur dhe të përgjegjësve zyrtarë të drejtimit të zgjedhjeve.
- 133.** Platformat digjitale duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të garantuar që përdoruesit të kenë mundësi në përdorimin e informacionit dhe të ideve të të gjitha

42. Më shumë informacion mund të gjeni në "Zgjedhjet në kohërat digjitale: Një udhëzues për praktikantët zgjedhorë" të UNESCO-s (2022), <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000382102>, dhe në "Deklaratën e Përbashkët për Lirinë e shprehjes në epokën digjitale të Raportuesit Special të OKB-së për Lirinë e Opinionit dhe Shprehjes, përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave dhe Raportuesit Special të OAS për Lirinë e Shprehjes" (2020), [https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/Opinion/JointDeclarationDigitalAge\\_30April2020\\_EN.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/Opinion/JointDeclarationDigitalAge_30April2020_EN.pdf).

Ilojeve, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Në veçanti, ato duhet të garantojnë që mjetet e automatizuara të mos e pengojnë mundësimin e përdorimit të përmbajtjes, që lidhet me zgjedhjet dhe pikëpamjet e ndryshme.

- 134.** Në kuadër të vlerësimeve, platformat digjitale duhet të verifikojnë nëse produktet, politikat ose praktikat e tyre mbi publicitetin politik kufizojnë arbitrarisht aftësinë e kandidatëve ose të partive të përhapin mesazhet e tyre.
- 135.** Platformat digjitale duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të trajtuar përmbajtjet që mund të autorizohen si subjekt kufizimi sipas standardeve dhe legjislacionit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, gjatë fushatës elektorale. Duhet marrë në konsideratë inkurajimi i verifikimit të pavarur të fakteve dhe arkivat e publicitetit, paralajmërimi i publikut dhe të tjera masa. Mund të jetë e nevojshme përfshirja e institucioneve rregullatore zyrtare e të pavarura, sipas rrethanave të veçanta të secilit juridiksion.
- 136.** Platformat digjitale, në këtë rast, duhet të jenë transparente për përdorimin dhe ndikimin praktik të çdo mjeti të automatizuar që përdorin, por jo domosdoshmërisht për kodin e veçantë me të cilin funksionojnë këto mjete, përfshirë dhe masën në të cilën ato ndikojnë në mbledhjen e të dhënave, publicitetin e objektivit dhe bashkëndarjen, renditjen dhe/ose heqjen e përmbajtjes, veçanërisht përmbajtjen që lidhet me zgjedhjet.
- 137.** Platformat digjitale duhet edhe të bashkëpunojnë me të gjitha palët e përfshira dhe me sistemin e tyre të administrimit përpara dhe gjatë zgjedhjeve, për të vendosur një mjet komunikimi, nëse shqetësimet janë ngritur nga administratorët ose nga përdoruesit/votuesit. Bashkëpunimi me institucionet rregullatore zyrtare përkatëse mund të jetë i nevojshëm sipas rrethanave të veçanta të secilit juridiksion.
- 138.** Platformat digjitale, që pranojnë publicitetin e krijuar për të ndikuar fushatën elektorale duhet t'i sqarojnë qartësisht këto përmbajtje si publicitet elektoral. Normativat e shërbimit të platformave digjitale duhet të jenë të qarta për përgjegjësinë e tyre për të qenë transparente rreth shumës së fondeve, të entit që ofron fondet dhe për entitetin e reklamuar, dhe të zbatojë në vazhdimësi kontroll të barabartë dhe mbrojtje të rregullave në çdo publicitet.
- 139.** Platformat digjitale duhet të ndjekin fitimet e parave të postimeve nga partitë politike dhe të personave përfaqësues të partive.
- 140.** Platformat duhet t'i shpërndajnë publikut informacion mbi objektiva të veçanta demografike, të targetuara nga këto reklama/promocione.

**141.** Platformat duhet t'i ruajnë këto reklama dhe të gjitha informacionet lidhur me fondet në një në bibliotekë online lehtësisht të arritshme për publikun dhe rregullisht të përditësuar.

### ***Masa të veçanta në raste urgjence, konfliktesh të armatosura dhe krizash.***

**142.** Si mbrojtëse të të drejtave të njeriut, platformat digjitale duhet të vigjilojnë respektimin e të drejtave të njeriut në raste krizash, situatash konflikti të armatosur dhe urgjenca të tjera, përfshirë urgjencat shëndetësore. Kjo vëmendje e veçantë duhet të analizojë ndikimin e të drejtave të njeriut të veprimeve të kompanive, të produkteve, shërbimeve dhe të sistemeve të publicitetit mbi krizat dhe dinamikat e konfliktit.

**143.** Gjatë konflikteve të armatosura dhe krizave, platformat duhet:

**a.** Të garantojnë që kontrolli i përmbajtjes në kontekstin e konfliktit të përfshijë edhe një rishqyrtim njerëzor të rreptë, duke integruar ekspertizën në gjuhët përkatëse dhe në kontekstin lokal e rajonal.

**b.** Të kryejnë verifikim të fakteve.

**c.** Të krijojnë kanale për përfshirje të plotë dhe të drejtpërdrejtë me palët partnere, si dhe me ato që operojnë në zonat e prekura nga konflikti ose në rrezik të lartë.

**d.** Të zhvillojnë bashkëpunimin me partnerë të besueshëm, organizatat e medias së pavarur dhe palë të tjera të besueshme.

**e.** Të krijojnë menjëherë sisteme alarmi dhe sisteme të qarta të zgjidhjes së problemit në situata urgjente, për të diktuar një rrezik të afërt për sigurinë fizike të personave.

**f.** Të zbatojnë politika për të kufizuar dhe për të ndjekur financimin e përmbajtjeve dëmtuese, të lidhura me konflikte të armatosura.

**g.** Të ruajnë të gjitha provat e mundshme të shkeljes së të drejtave të njeriut ose të krimeve të luftës, duke i mundur hyrjen në materialin e arkivuar mekanizmave përgjegjëse të autoriteteve kombëtare ose ndërkombëtare.

**144.** Vlerësimi i riskut mund të kërkojë që platformat digjitale të krijojnë procedura për rastet në të cilat ka shumë kërkesa njëherazi për veprim, si ndodh shpesh në kontekste të turbullirave sociale ose të dhunës masive. Sistemi i administrimit duhet të veprojë sipas udhëzuesve ekzistues të agjencive të OKB-së dhe të ekspertëve, për të ndërmarrë aksione të përforcuara në mbrojtje të të drejtave të njeriut, në të tilla situata.



## Përfundime

**145.** Platformat digjitale i kanë dhënë individëve dhe shoqërive mundësi të jashtëzakonshme për të komunikuar, për t'u përfshirë dhe për të mësuar. Ato u ofrojnë një potencial të madh grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara, duke demokratizuar hapësirën në rrjet për komunikim dhe mundësi shkëmbimi e përfshirjeje të zërave të ndryshëm me njeri-tjetrin, ku të kuptohen dhe të dëgjohen. Megjithatë, potenciali i këtyre platformave është gërryer dalëngadalë gjatë viteve të fundit për shkak të mungesës së parashikimit për të zgjidhur problemet e risqeve kryesore.

**146.** Qëllimi i Udhëzuesve është të mbrojnë lirinë e shprehjes, mundësimin e përdorimit të informacionit dhe të të drejtave të tjera njerëzore në administrimin e platformës digjitale, duke i kushtuar vëmendje të paprerë përmbajtjeve që autorizohen të kufizohen sipas standardeve dhe legjisllacionit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Për më tepër, administrimi i platformave digjitale, i ngritur dhe i bazuar te të drejtat e njeriut do të promovojë më tej diversitetin kulturor, diversitetin e shprehjes dhe përmbajtjen e ndryshme kulturore.<sup>43</sup> Udhëzuesit përkrahajnë një sistem administrimi respektues të të drejtave të njeriut, që nxit uljen e riskut dhe sisteme të procedurave, të bazuara në kontrollin e përzgjedhjen e përmbajtjes. Këto Udhëzues vënë në dukje parimet themelore që duhen ndjekur në të gjitha sistemet administruese, që ndikojnë në lirinë e shprehjes dhe mundësimin e përdorimit të informacionit mbi platformat digjitale, pavarësisht nga dispozitat rregullatore dhe fokusi tematik, për sa kohë këto

43. Konventa e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore të Vitit 2005, në nenet 1 dhe 4. Në këtë Konventë, "përmbajtja kulturore" përmendet si kuptime simbolike, dimension artistik dhe vlera kulturore që vijnë nga ose shprehin identitetet kulturore. Për më tepër, "shprehjet kulturore" janë ato shprehje që rrjedhin nga kreativiteti i individëve, grupeve dhe shoqërive, dhe që kanë përmbajtje kulturore.

dispozita janë në harmoni me dispozitat e paraqitura në këta Udhëzues.

**147.** Udhëzuesit janë hartuar në kuadrin e një procesi konsultimi shumëpalësh, i cili filloi punën në shtator 2020. Këto Udhëzues të tanishëm janë rezultat i procesit të zgjeruar konsultativ, në të cilin UNESCO mori, përmes tre konsultimeve të hapura,<sup>44</sup> më shumë se 1540 propozime me më shumë se 10.000 komente. Në këtë proces u përfshinë grupe të ndryshme palësh të interesuara nga 134 vende. Prosesi ishte një nga ushtrimet e konsultimeve më të zgjeruara të realizuara nga UNESCO-ja.

**148.** Do të organizohen diskutime të mëtejshme mbi mënyrën e vënies në zbatim të Udhëzuesve dhe për t'í përdorur më pas si mjet avokatie, me synim mbrojtjen e lirisë së shprehjes, mundësimin të përdorimit të informacionit, të përmbajtjeve të ndryshme kulturore dhe të të gjitha të drejtave të tjera të njeriut në mjedisin digjital.

---

44. Tre konsultime të hapura u zhvilluan mes dhjetorit 2022 dhe janarit 2023; mes shkurtit dhe marsit 2023; dhe mes prillit dhe qershorit 2023.

# Shtojcë

## Burimet

### Kombet e Bashkuara

*Parimet Udhëzuese për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut* (2011)

[https://www.ohchr.org/sites/default/files/documents/publicationsguidingprinciplesbusinesshr\\_en.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/documents/publicationsguidingprinciplesbusinesshr_en.pdf)

*Plani i Veprimit i Rabatit mbi ndalimin e gjuhës së urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, të cilat përbëjnë nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë* (2012)

<https://www.ohchr.org/en/documents/outcome-documents/rabat-plan-action>

Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për lirinë e mendimit dhe shprehjes: “Një qasje e të drejtave të njeriut ndaj moderimit të përmbajtjes në internet.” (2018)

[https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/Expression/Factsheet\\_2.pdf](https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/Expression/Factsheet_2.pdf)

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës: “Komenti i përgjithshëm Nr. 25 (2021) mbi të drejtat e fëmijëve në lidhje me mjedisin digjital.” (2021)

<https://www.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/general-comment-no-25-2021-childrens-rights-relation>

Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së: “Kundërshtimi i dezinformimit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.” (2022)

<https://www.ohchr.org/sites/default/files/2022-03/NV-disinformation.pdf>

Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e mendimit dhe të shprehjes: “A/77/288: Dezinformimi dhe liria e mendimit dhe e shprehjes gjatë konflikteve të armatosura.” (2022)

<https://www.ohchr.org/en/documents/thematic-reports/a77288-disinformation-and-freedom-opinion-and-expression-during-armed>

“Agjenda jonë e përbashkët - Përmbledhje Politike 8: Integriteti i Informacionit në Platformat Digjitale.” (2023) nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së

<https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/our-common-agenda-policy-brief-information-integrity-en.pdf>

Agjenda jonë e përbashkët - Përmbledhje Politike 5: “Një Marrëveshje Globale Digjitale”

<https://indonesia.un.org/sites/default/files/2023-07/our-common-agenda-policy-brief-gobal-digi-compact-en.pdf>



## UNESCO

Puddephatt, A. 2021. Lër Diellin të Shkëlqejë: Transparenca dhe Përgjegjshmëria në Epokën Digjitale Paris. UNESCO. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000377231>

UNESCO. 2021. "Kufijtë legjitimë të lirisë së shprehjes: Testi me tre pjesë." [video] <https://www.youtube.com/watch?v=Wg8fVtHPDag>

## Referimet për terminologjinë

### Përmbajtjet të cilat nxisin ose shprehin dhunë me bazë gjinore.

- Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut. 2018. "Raporti i Raportuesit Special për dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat e saj në dhunën në internet ndaj grave dhe vazave nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut". <https://daccess-ods.un.org/access.nsf/Get?OpenAgent&DS=A/HRC/38/47&Lang=E>
- OHCHR. 2021. "Deklaratë e Irene Khan, Raportuese Speciale për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes." <https://www.ohchr.org/en/statements/2022/02/statement-irene-khan-special-rapporteur-promotion-and-protection-freedom-opinion>

### Diversiteti kulturor

"Diversiteti kulturor" i referohet mënyrave të shumta në të cilat kulturat e grupeve dhe shoqërive gjejnë shprehje. Këto shprehje transmetohen brenda dhe midis grupeve dhe shoqërive. Diversiteti kulturor manifestohet jo vetëm nëpërmjet mënyrave të ndryshme në të cilat trashëgimia kulturore e njerëzimit shprehet, shtohet dhe transmetohet përmes shumëllojshmërisë së shprehjeve kulturore, por edhe nëpërmjet mënyrave të ndryshme të krijimit, prodhimit, qarkullimit, shpërndarjes dhe kënaqësisë artistike, pavarësisht nga mjetet dhe teknologjitë e përdorura."

- UNESCO. 2005. *Konventa e vitit 2005 për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore*. Paris: UNESCO. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000246264?posInSet=1&queryId=85dde93e-9ef6-402b-bc9f-452e6a399382>

### Dezinformimi dhe keqinformimi

- "Dezinformimi dhe liria e mendimit dhe e shprehjes." Raporti i Raportuesit Special për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtës për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes,

## Gjuha e urrejtjes

- OKB. 2019. "Strategjia dhe Plani i Veprimit i OKB për gjuhën e urrejtjes." <https://www.un.org/en/genocideprevention/hate-speech-strategy.shtml>

## Rregullatori i pavarur

Rregullatori i pavarur ka fuqitë dhe përgjegjësitë e tij të vendosura në instrumentin e legjislacionit publik dhe ka autoritetin të administrojë burimet e tij; anëtarët e tij emërohen në mënyrë të pavarur dhe mbrohen me ligj ndaj çdo pushimi të pajustificuar nga puna. Në rast të tillë, vendimet e rregullatorit merren pa miratim të mëparshëm të ndonjë enti tjetër administrues dhe të asnjë enti tjetër, përveçse një gjykatë ose një këshilli apelues të paravendosur, i cili mund të anulojë vendimet e rregullatorit. Elementët institucionalë për marrjen e pavarur të vendimeve janë pavarësia e organizuar (e ndarë prej ministrive ekzistente dhe departamenteve të tyre), pavarësia financiare (sistemi i ndihmës i rezervuar, i siguruar dhe burime të përshtatshme fondesh) dhe pavarësi administrimi (autonomi administrimi të brendshëm dhe mbrojtje ndaj pushimeve nga puna pa motivim të justifikuar.)

- Salomon, E. 2016. *Udhëzime për Rregulloren e Transmetimit*. Paris: UNESCO. <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000144292>
- Brown, A., J. Stern, B. Tenenbaum, and D. Gencer. 2006. *Manual për Vlerësimin e Sistemeve Rregullative të Infrastrukturave*. Washington, DC: World Bank Group. <http://elibrary.worldbank.org/doi/book/10.1596/978-0-8213-6579-3>

## Rregullator

Ent, i cili mbikëqyr dhe monitoron përgjegjësinë e një institucioni privat.

## Udhëzues për administrimin e platformave digjitale

Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe mundësisë së përdorimit të informacionit përmes një qasjeje shumëpalëshe

Të hartuara përmes një konsultimi të zgjeruar, këta Udhëzues synojnë mbrojtjen e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe mundësimin të përdorimit të informacionit në kontekstin e administrimit të platformave digjitale. Ato përfaqësojnë një qasje shumëpalëshe, duke vënë në dukje përgjegjësitë kryesore për shtetet dhe platformat digjitale për të përmbushur detyrimet e tyre ndaj të drejtave të njeriut dhe për të përcaktuar rolet për organizatat ndërqeveritare, shoqërinë civile, median, akademitë, komunitetet teknike dhe palë të tjera të interesuara.

[www.unesco.org/en/internet-trust/guidelines](http://www.unesco.org/en/internet-trust/guidelines)

[internetconference@unesco.org](mailto:internetconference@unesco.org)



**unesco**

Organizata e Kombeve  
të Bashkuara për Arsim,  
Shkencë, dhe Kulturë



**Këshilli  
Shqiptar  
i Medias**

